



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

PROGRAMI I MAGJISTRATURËS: DREJTIMI JURIDIKO - PENAL

TEZA E MAGJISTRATURËS:

**“VEPRA PENALE E VRASJEVE TË RËNDA NË
RRETHIN E GJYKATËS THEMELORE NË TETOVË
PËR PERIU DHËN PREJ VITIT
2012 DERI VITIN 2018”**

KANDIDATI

Florinda Sulejmani

MENTORI

Prof.Dr.Ismail Zejneli

Tetovë, Nëntor 2019

PËRMBAJTJA

“VEPRA PENALE E VRASJEVE TË RËNDA NË RRETHIN E GJYKATËS THEMELORE NË TETOVË PËR PERIUdhËN PREJ VITIT 2012 DERI VITIN 2018”

- HYRJE.....5
- QËLLIMI I PUNIMIT.....6
- METODOLOGJIA E PUNIMI6

KREU I PARË

HISTORIKU I DËNIMIT ME BURG, VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM , KARAKTERISTIKAT E DËNIMIT ME BURG, QËLLIMI I DËNIMIT, RREGULLAT MINIMALE STANDARDE TË OKB-SË

1. ASPEKTI HISTORIK I DËNIMIT ME BURG.....8
2. VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM MBI SISTEMIN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT ME BURG.....11
3. KARAKTERISTIKAT E DËNIMIT ME BURG.....17
4. QËLLIMI I DËNIMIT ME BURGIM SIPAS KODIT PENAL TË RM-SË.....20
5. DËNIMI ME BURG SIPAS KODIT PENAL TË MAQEDONISË.....22
6. RREGULLAT MINIMALE STANDARDE TË OKB-SË, PËR TRAJTIMIN E TË BURGOSURVE.....24

KREU I DYTË

NOCIONI, LLOJET E VRASJEVE, VEPRIMI I KRYERJES, PASOJAT

1. VEPRA PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT.....29
 - 1.1 NOCIONI I VRASJES.....30
2. DISA LLOJE TË VRASJES SË RËNDË.....31
 - 2.1 VRASJA NË MËNYRË MIZORE.....32
 - 2.2 VRASJA NË MËNYRË TINZARE.....32

2.3 VRASJE ME DASHJE ME Ç’RAST RREZIKOHET JETA E PERSONAVE TJERË.....	32
2.4 VRASJA ME QËLLIM TË FITIMIT TË DOBISË PASURORE.....	33
2.5 VRASJA E PERSONIT ME QËLLIM TË FSHEHTËSIS SË VEPRËS PENALE.....	33
2.6 VRASJA NGA HAKMARRJA E PASKRUPULLT.....	34
2.7 VRASJA NGA MOTIVET E ULËTA.....	34
2.8 VRASJA NË BAZË TË POROSISË.....	35
2.9 VRASJA E GRUAS SHTATËZËNË.....	35
3. VRASJA NGA MOTIVET FISNIKE.....	35
3.1 EUTANAZIA.....	35
4. VRASJA NGA PAKUJDESIA.....	36
5. VRASJA E FOSHNJËS GJATË LINDJES (FËMIJË VRASJA).....	37
6. OBJEKTI I MBROJTJES DHE OBJEKTTI I VEPRIMIT.....	37
6.1 RËNDËSIA E OBJEKTIT TË MBROJTJES.....	38
7. VEPRIMI I KRYERJES.....	39
8. PASOJA.....	40

KREU I TRETË

ASPEKTET KRIMINOLOGJIKE TË DËNIMIT ME BURG

1. FENOMENOLOGJIA E SHQYPTIMIT TË DËNIMIT ME BURG NË RRETHIN E GJYKATËS THEMELORE TË TETOVËS GJATË VITEVE 2012 DERI VITIT 2018.....	41
1.1 STRUKTURA E PERSONAVE TË DËNUAR.....	43
1.1.1 MOSHA E PERSONAVE TË DËNUAR.....	45
1.1.2 GJINIA E PERSONAVE TË DËNUAR.....	47
1.2 NACIONALITETI I TË DËNUARVE ME BURG.....	49
1.3 RECIDIVIZMI.....	50

1.3.1 FAKTORËT QË NDIKOHEN NË PARAQITJEN E RECIDIVIZMIT.....	52
2. TENTATIVA E VEPRËS PENALE.....	54
2.1 DALLIMI MIDIS VEPRIMEVE PËRGADITORE DHE TENTATIVËS.....	57
2.2 NDËSHKIMI I TENTATIVËS.....	59
2.3 RASTET E POSAÇME TË TENTATIVËS.....	60

KREU I KATËRT

ANALIZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE, POLITIKA KRIMINALE

1. ANALIZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE TË PËRGATITURA NGA ANA E GJYKATËS THEMELORE NË TETOVË.....	61
2. GJYKIM.....	68
3. POLITIKA KRIMINALE.....	68
3.1 POLITIKA KRIMINALE DHE LIDHJET E SAJ ME SHKENCAT E TJERA.....	68
3.1.1 POLITIKA KRIMINALE DHE E DREJTA PENALE.....	68
PËRFUNDIMI.....	70
REKOMANDIMET.....	71
LITERATURA.....	72

HYRJE

Vepra penale është akt negativ i njeriut dhe i dëmshëm për shoqërinë. Paraqitet si rezultat i konflikteve ndërmjet individëve dhe interesave të tyre, individëve dhe shoqërisë, si mospajtim ndërmjet dëshirave, nevojave dhe mundësisë për përmbushjen e tyre, si rezultat i ndonjë tronditjeje ose si dalje nga kriza, përkatësisht si zgjidhje negative e ndonjë situatë konflikti ose situatë stresi. Ajo është më së shpeshti akt i vetëdijshëm dhe i vullnetshëm, por mund të jetë edhe akt i pamtur, si dhe akt i projektimit të imagjinatës së sëmurë dhe halucinacionit, përkatësisht rezultat i sëmundjes ose çrregullimit shpirtëror.

Sot nuk ekziston legjislacion penale që nuk u ofron mbrojtjen këtyre të mirave themelore dhe më të vlefshme të njeriut. Vetëdija për karakterin e tyre universale është inkorporuar edhe në më shumë dokumente ndërkombëtare të rëndësisë fundamentale për liritë dhe të drejtat e njeriut kështu: Deklarata Universale për të drejtat e njeriut e OKB-së e vitit 1984, neni 3; Pakti për të drejtat civile dhe politike, neni 6, ku thuhet: çdo njeri ka të drejtën e lindur në jetë, që duhet të mbrohet me ligj, askush nuk mund në mënyrë arbitare të privohet nga jeta. Pacënueshmëria e jetës dhe integriteti trupor të ne është ngritur në rang të parimit kushtetues, (neni 10 i Kushtetutës së RM-së).

Qëllimi i studimit të kësaj disipline juridike dhe shkencore është që tu ofrojë studentëve të rinjë njohuri thelbësore lidhur me strukturën e veprave penale veç e veç, dhe në përgjithësi pjesës së posaçme të Kodi Penal.

Të kuptojnë se fenomeni dinamik dhe kompleks i kriminalitetit është një nga problemet më aktuale dhe preokupuese për shoqërinë bashkëkohore.

Ky punim shkencor në brendi do të përmbajë: hyrjen, përmbajtjen, kapitullin, përfundimin, rekomandime dhe literaturën e shfrytëzuar.

Në kreun e parë do të paraqesim historikun e dënimit me burgim, zanafillën dhe paraqitja e saj në fillimet e hershme, format dhe mënyrat e mbajtjes së dënimit me burg dhe trajtimin e njejtës. Gjithashtu në këtë kre do të paraqesim karakteristikat e dënimit me burg, qëllimin dhe rregullat minimale standarde të OKB-së, për trajtimin e të burgosurve.

Në kreun e dytë qëllimi i këtijë punimi shkencor është paraqitja e vrasjes së rëndë, llojet e vrasjes, veprimi i kryerjes, pasojat sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë.

Në kreun e tretë iu referuar evidencave dhe duke shfrytëzuar statistikat që mbahen në Gjykatën themelore në Tetovë gjatë viteve 2012 deri vitin 2018 do të bëhet shikimi i të njëjtave duke i analizuar dhe do të paraqiten të dhëna të fituara në mënyrë statistikore.

Në kreun e katërt dhe të fundit qëllimi kryesor është analiza e të dhënave statistikore të përgatitura nga ana e Gjykatës themelore në Tetovë dhe politika kriminale.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Një ndër qëllimet kryesore të këtij punimi, veprimi njerëzor është shpallur si vepër penale dhe ajo është e ndaluar me ligj për arsye se paraqet shkelje apo kërcënim të vlerave dhe të mirave individuale dhe shoqërore. Bëhet fjalë për definim sintetik që nis nga e padrejta ligjore: ndonjë sjellje bëhet e ndaluar për arsye se si shkelje e të mirave të caktuara juridike në kuptimin objektiv është jo e drejt që domethënë nuk është jo e drejtë ajo çka është e ndaluar, por e ndaluara që është jo e drejtë!

Me qëllim të ruajtjes së rendit juridik dhe shoqërisë në përgjithësi nga kryerësit e veprave penale për vrasje të rënda, dënimi me burg është dënim me anë të të cilit bëhet parandalimi i autorit të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjithashtu duke ndikuar në riedukimin e tij, kurse nga ana tjetër ndikimi edukativ në ngritjen e vetëdijes mbi të tjerët të mos kryejnë vepra penale, me çka sipas KPM-së arrihen dy qëllime, edhe atë: qëllimi retributiv – dënimi i kryerësit si formë e shpagimit dhe qëllimi edukativ – të tjerët të mësohen nga këto raste.

Poashtu përmes këtij punimi do të tentoj të jap një pasqyrë sa më të qartë në lidhje me kategoritë e personave të cilët kan kryer vrasje dhe që gjenden në vuajtje të dënimit siç janë gjinia, mosha, etnia, feja, statusi ekonomik, statusi civil, veprat penale për të cilat janë të dënuar të njëjtët etj.

Gjithashtu ky punim shkencor le të jetë si një porosi përcjellëse për respektimin e ligjeve pozitive dhe respektimin e të drejtave njerëzore, që të kemi përmirësime kualitative dhe rrënie të kësaj dukurije, me qëllim të zhvillimit më të lartë institucional dhe të ngritjes së vetëdijes më të lartë tek qytetarët.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij punimi bazohet në një studim të kujdesshëm dhe hulumtim të thellë. Për një punim shkencor të suksesshëm duhet të përcaktohen mënyrat dhe

format e hulumtimit do të na shpiejnë në mënyrën dhe rrugën më të lehtë dhe më precize deri te informatat adekuate për punimin shkencorë, që në këtë rast është vepra penale për vrasje të rënda. Metodat gërshetohen në mes veti duke e plotësuar njëra tjetrën dhe nga të dhënat e fituara realizohet qëllimi i pritur nga njëra te metoda tjetër.

Hulumtimi i kësaj teme është i mbështetur nga të dhëna dhe burime të ndryshme. Duhet të potencohet se udhëzimet dhe këshillat e mentorit kanë rol të rëndësishëm në përpilimin e këtij punimi.

Në punimin shkencor me titull: “Vepra penale e vrasjeve të rënda në rrethin e Gjykatës Themelore në Tetovë për periudhën 2012 deri 2018” për të ju qasur hulumtimit kam përdorur këto metoda:

- Metoda historike, (nëpërmjet të cilës jepet sqarim rreth dënimit me burg duke filluar prej zanafillës dhe të gjitha ndryshimet dhe format e paraqitjes që ka pësuar nëpër vite ky dënim).
- Metoda karahsuese, (vlenë të përdoret pasi që me ndihmën e saj do të bëjmë krahasimin e kodit penal gjegjësisht dënimin me burg për peridhën 2012 deri në vitin 2018 në territorin e Gjykatës themelore të Tetovës).
- Metoda statistikore, (me anë të së cilës do të jepen të dhëna statistikore për rastet e kryerësve për kryerjen e veprës penale për vrasje të dënuar me burgim në Gjykatën themelore në Ttetovë gjatë periudhës prej vitit 2012 deri 2018).
- Metoda dogmatike juridike, (pa te cilën asnjë punim i mirëfillt shkencor nuk mund të bazohet pa këtë metodë).
- Metoda empirike
- Metoda analitike dhe induktive.

KREU I PARË

1. ASPEKTI HISTORIK I DËNIMIT ME BURG

Dënimet me burg janë sanksione penale të cilat, në shtetet bashkëkohore, aplikohen më së shumti në praktikën gjyqësore. Këto dënime zënë vend qendror në sistemin e sanksioneve penale. Paraqitja e dënimeve me burgim, fillon që nga koha e burgjeve të para e deri te dënimet bashkëkohore me burgim.

Burgosja dhe privimi nga liria, i kryerësve të veprave penale dhe personave të tjerë që sillshin në mënyrë devijante, paraqitet shumë më herët se sa paraqitja formale e dënimit me burg si dënim me burgim. Burgosja e njerëzve është e njohur që nga kohërat më të vjetra. Burimet historike flasin se e drejta e shteteve të lashta si e drejta kineze, e drejta asirase, e drejta egjiptase dhe të drejtat tjera e kanë njohur burgun. Në Greqinë dhe Romën e Vjetër dhe në disa shtete mesjetare, gjithashtu kanë ekzistuar burgje. Këto burgje kanë qenë të vendosura në kështjella të vjetra “Bastilles”, ose në bodruet e kalave “Qublittes”, të cilat kanë qenë të braktisura, ndërsa kushtet e qëndrimit kanë qenë shumë të rënda dhe të vështira. Në këto burgje qëndronin persona të cilët kishin kryer sjellje të ndryshme delikente, sidomos vjedhësit dhe bredhësit. Në literaturë theksohet se në këto burgje, veçmas në kohën e mesjetës, dërgoheshin persona të dyshimtë, në bazë të urdhërësave sekrete të mbretërve që në Francë njiheshin me emrin “Lettre de cachet”. Këto burgje kanë shërbyer si masë preventive ndaj një kategorie të delikuentëve, ndërsa ndaj të tjerëve këto burgje kanë shërbyer vetëm si qëndrim i përkohshëm deri sa të mbahet gjykimi dhe të shqiptohet dënimi kryesor.¹

Gjatë shekujve XVI dhe XVIII, në shumë vende evropiane ndodh një lëvizje e madhe e popullsisë në relacionet fshat-qytet, e posaçërisht vjen e rritet klasa qytetare e popullsisë. Kjo me vete sjell grumbullimin e madh të banorëve nëpër qytet. Në anën tjetër, kjo gjendje ndikon në shtimin e personave të papunë, në shtimin e endacakëve dhe alkoolistëve të ndryshëm të cilët për ambientin e caktuar paraqitnin masa për mbrojtjen e shoqërisë nga këto kategori të personave dhe nga sjelljet e tyre të rrezikshme. Si masa dhe forma për luftimin dhe pengimin e këtyre dukurive, në disa qendra dhe shtete të Evropës propozohet themelimi i disa institucioneve dhe institucioneve të veçanta për vendosjen e këtyre kategorive të delikuentëve. Në këto ente vendoseshin bredhësit, lypësit, alkoolistët dhe prostitutat, të cilat detyroheshin të punojnë dhe të krijojnë shprehi të punës. Në këtë mënyrë pengohet sjellja e tyre delikente dhe mbrohet shoqëria nga kriminaliteti.²

¹ Halili.Ragipi, Penologjia, Prishtinë, 2011, faqe 93.

² Po aty, faqe 94.

Nga shqyrtimet e paraqitura del se burgimi si formë e heqjes së lirisë dhe mjet i mbrojtjes nga kriminaliteti, ka kaluar nëpër dy faza kryesore: nëpërmes fazës preventive dhe fazës së dënimit si mjet dhe sanksion penal. Burgimi si mjet preventiv, siç u pa, ka pasur disa forma të veta. Në fillim është trajtuar si paraburgim, deri sa nuk është shqiptuar dënimi kryesor. Pra, ai në këtë fazë, ishte një farë burgu hetues derisa nuk përfundonte trajtimi dhe shqyrtimi i çështjes nga gjykata.³

Si faktorë themelorë që kanë kontribuar në paraqitjen e dënimit me burgim janë:

1. Mendimet dhe idetë humaniste e përparimtare të filozofëve dhe shkollave të ndryshme;
2. Idetë dhe kontributi i Revolucionit francez dhe legjislacioni i tij penal dhe ndikimi i pranisë së lirive dhe të drejtave të qytetarëve si dhe
3. Shfrytëzimi i punës së personave të dënuar si fuqi e lirë punëtore.⁴

1. Mendimet dhe idetë humaniste e përparimtare lidhur me shkaqet e kriminalitetit e veçmas me politikën ndëshkimore dhe nevojën e reformimit të burgjeve paraqiten qysh herët, në punimet dhe veprat e filozofëve dhe mendimtarëve të mirënjohur, si: T.Mor, H.Grocus, Zh.Ruso, Monteskje, C.Bekarie, Xhon Huard etj. Këta, në mënyrë sistematike dhe të ashpër, kanë kritikuar politikën dhe sistemin ndëshkimor dhe gjendjen e burgjeve në shoqërinë feudale e sidomos aplikimin dënimeve me vdekje, torturave fizike dhe format tjera të ndëshkimit degradues. Ata kanë propozuar që këto dënime barbare dhe çnjerëzore të zëvendësohen me dënime me burgim. Po ashtu ata janë angazhuar që personat e dënuar të kyçen në procesin e punës me qëllim të përmirësimit të tyre. Sipas tyre, hakmarja nuk duhet të jetë si qëllim vetëm i dënimit, por dënimi duhet të ndikojë në përmirësimin dhe riedukimin e tyre. Këto ide, edhe pse u paraqitën në shoqërinë feudale, nuk arritën të realizohen në atë kohë. Ato u realizuan vetëm në kushtet që u krijuan pas Revolucionit borgjez francez.⁵

2. Revolucionit francez sjell ndërrime rrënjësore të bazës juridike dhe shoqërore të së drejtës penale dhe të sistemit ndëshkimor. Ai ndikon në nxjerrjen e një varg ligjesh të reja ku parashikohen dënimet me burgim si dënime kryesore për një varg veprash penale, për të cilat më parë zakonisht shqiptohej vetëm dënimi me vdekje apo dënimet me tortura fizike. Tani dalin në pahë parimet e njohura të shkollave dhe lëvizjeve humaniste historike-juridike, si p.sh: parimi i ligjshmërisë, i cili shprehet në rregullën “nulum crimenn sine lege, nula poena sine lege“, parimi barazisë qytetare para ligjit dhe parimet e tjera. E drejta për jetë, e drejta për liri, e drejta e pronës, e drejta e mendimit të lirë dhe e drejta e qarkullimit, konsiderohen dhe bëhen vlera më të mëdha. Në këtë mënyrë,

³ Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2011, faqe 95.

⁴ Po aty, faqe 96.

⁵ Po aty, faqe 96-97.

zëvendohen dënimet vdekje, dënimet fizike, torturat fizike, dënimet morale dhe çnjerëzore me dënim me burgim.⁶

3. Fuqia e lirë punëtore e personave të dënuar dhe dëshira e shoqërisë borgjeze që të përfitojnë kapital ishte një ndër arsyet e paraqitjes së dënimeve me burgim. Pushteti ishte i interesuar që ndaj personave të dënuar mos të aplikohen më tej dënime me vdekje dhe dënime e tortura fizike, por dënime me burgim, ngase në këtë mënyrë ekziston mundësia e shfrytëzimit të tyre për punë në industri dhe në punë të tjera publike. Personat e dënuar, duke u kyçur në punë publike apo në punë të ndërmarrjeve të ndryshme, në një mënyrë zhdëmtonin dhe kompensojnë dëmin ndaj shoqërisë, për krimet e kryera. Kjo punë ishte mjaft e vështirë dhe e rëndë, personat e tillë të dënuar nuk kishin kurrfarë shpërblimi për punë. Ky sistem i angazhimit të personave të dënuar në punë fizike është kritikuar si johuman dhe i vrazhdë. Por, sido që të jetë, ai ka qenë faktorë që ka ndikuar në paraqitjen dhe zbatimin e dënimit me heqje të lirisë.⁷

4. Format e dënimeve me burgim dhe transformimi i tyre

Dënimi me burgim si sanksion penal, sipas konstatimeve në literaturë, për herë të parë është paraprë në Kodin Penal francez të vitit 1792. Kjo konsideron edhe si kohë e paraqitjes dhe aplikimit të dënimeve me burgim në praktikën gjyqësore si sanksione penale për luftimin e kriminalitetit. Duhet theksuar se dënimet me burgim, pas Kodit Penal të vitit 1792, e veçmas pas Kodit të Napoleonit, të vitit 1810, aplikohen dhe parashikohen në të gjitha kodet penale të Evropës dhe SHBA-ve. Dënimet me burgim shumë shpejt u përkrahën dhe u parapanë si sanksione penale në shumë ligje dhe kode penale. Rruga e transformimeve dhe ndryshimeve të dënimeve me burgim mund të përcillet në tre faza:

Faza e parë: përfshinë kohën që nga paraqitja e këtyre dënimeve e deri te gjysma e parë e shkullit XX. Kjo fazë karakterisohet me afrimimin e dënimeve me heqjen e lirisë si dënime më të favorshme dhe më humane për kryerësin e veprës penale. Në këtë periudhë, dënimet me burgim bëhen dënime dominuese, dallohen disa lloje të dënimeve me burgim: burgimi, internimi, burgu i rëndë, burgu shtëpijak, burgu i përjetshëm, burgu me pranga, burgu i lehtë etj.

Karakteristikë për këtë fazë të dënimeve me burgim është fakti se kanë ekzistuar një numër i madh i formave të dënimeve me burgim. Gjithashtu, edhe mënyra e ekzekutimit të këtyre dënimeve ka qenë e llojllojshme dhe zakonisht në fillim ka qenë e mbështetur në idenë dhe qëllimin e hakmarrjes dhe shpagimit.

⁶ Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2011, faqe 97

⁷ Po aty, faqe 97-98

Faza e dytë: e zhvillimit dhe transformimit të dënimit me burgim, përfshinë kohën e përpjekjeve të mëdha për transformimin e plotë të qëllimit dhe të karakterit të dënimit me burgim. Duhet theksuar se ky proces i transformimit ende nuk ka përfunduar dhe se edhe sot e kësaj dite vazhdon të hulumtojë format më të përshtatshme për zbatimin e dënimeve me burgim. Shumë autor mendojnë se dënimet me burgim duhet të unifikohen dhe të reduktohen në një dënim i cili ka për qëllim vetëm riintegrimin e personave të dënuar dhe pengimin e kriminalitetit. Autori i njohur francez Zhan Pinatel, thekson se dalëngadalë duhet të braktiset mendimi i gabuar që ka ekzistuar me shekuj se duke e mbrojtur personin e dënuar të privuar nga liria dhe të ndarë nga bota e lirë, ai mund të përgatitet për jetë në liri dhe mund të përmirësohet dhe riedukohet më sukses.

Faza e tretë: përfshin sanksionet dhe masat më të reja të cilat kanë ardhë në shprehje edhe në kodet dhe ligjet penale që janë aprovuar gjatë dekadave të fundit dhe në të cilat vend të veçantë zënë masat e diversitetit ndaj të miturve, dënimet alternative, dënimet me kusht, dënime plotësuese dhe format tjera të zëvendësimit të dënimit me burgim etj.⁸

2. VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM MBI SISTEMET E EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT ME BURG

Paraqitja e dënimeve me burgim ka qenë një hap i madh drejt humanizmit të reagimit të shoqërisë ndaj kriminalitetit e sidomos të tretmanit ndaj personave të dënuar.

Disa autorë mendojnë se ekzistojnë shumë sisteme, disa të tjerë ato i përqendrojnë vetëm në tri apo katër. Mirëpo, janë paraqitur të gjitha ato sisteme dhe metoda të ekzekutimit të dënimit me burgim të cilat në mënyrë kronologjike, historike, janë lajmëruar prej momentit të paraqitjes të dënimit me burgim e deri në ditët e sotme⁹. Të këtilla sisteme konsiderohen:

1. Sistemi i burgut kolektiv

Ky sistem është aplikuar që nga momenti i parë i paraqitjes së dënimeve me burgim dhe ka ekzistuar deri sa janë bërë reforma të dukshme të burgjeve në shekullin XIX. Si karakteristikë themelore e këtij sistemi është se të gjithë personat e dënuar me burgim, dënimin e mbajnë në mënyrë të përbashkët ose në mënyrë kolektive. Personat e dënuar sipas këtij sistemi, janë izoluar vetëm nga bota e jashtme, mirëpo brenda mureve të institucioneve – burgjeve, ata jetojnë në kolektiv.

⁸ Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2011, faqe 98.

⁹ Po aty, faqe 101.

Sipas këtij sistemi, nuk ka klasifikim të të dënuarve, ndodh që, së bashku dënimin ta mbajnë të dënuarit për krime të rënda, recidivistët, personat me karrierë të gjatë kriminale, personat e vjetër me të të miturit, kryerësit primar me kryerësit sekondar etj. Si lokale për ekzekutimin e dënimeve me burgim, gjatë aplikimit të këtij sistemi, në fillim shërbenin: bodrumet dhe lokalet e braktisura të fortesave, kështjellave, kalave dhe objekteve të vjetra ku kushtet e jetës ishin shumë të rënda. Kushtet higjienike dhe shëndetësore në këto burgje e ente ishin të mjerushme. Meqë në këto burgje nuk kishte ndarje dhe klasifikime të personave të dënuar dhe organizim të punës së tyre, në literaturën penologjike, konstatohet se ato e kanë nxitur krimin. Disa autorë, me të drejtë theksojnë se burgjet e këtilla kolektive ishin një “Universitet i vërtetë i krimit”, sepse këtu të dënuarit primarë kishin rast që të shoqërohen me të dënuar recidivistë dhe me “karrierë” të gjatë kriminale. Aty, personat e mitur mund të shoqëroheshin me persona të rritur dhe me provojë kriminale dhe nga ata të mësonin mënyrën, metodat dhe mjetet e kryerjes së krimeve. Prandaj, ky system është kritikuar për një varg dobësish.

Të dënuarit nëpër këto ente, në shumë raste kanë qenë të maltretuar dhe të nënshtruar ndaj keqtrajtimit dhe rrahjeve nga ana e gardianëve dhe personelit tjetër të burgut. Në këto burgje, shpeshherë ishin të pranishme dukuri dhe sjellje të ndryshme patologjike dhe negative si: prostituoni, bixhozi, alkoolizmi, mashtrimet, vrasjet dhe veprimet tjera të rrezikshme.¹⁰

2. Sistemi i izolimit ose i qelisë

Në literaturën penologjike dhe juridiko-penale, mendohet se vetëm me sistemin e izolimit fillon ekzekutimi i vërtetë i dënimit me burgim. Vetëm me inaugurimin e këtij sistemi, shteti fillon që në mënyrë të organizuar ta zbatojë dhe ekzekutojë dënimin me burgim dhe të marrë vetë përgjegjësinë për zbatimin në jetë. Në realitet, këtë sistem, për herë të parë e predikojnë dhe e sugjerojnë besimtarët e një sekte protestante, të sektës kuckere (Quakers' Solitary System). Pjesëtarët e kësaj sekte religjioze, ishin kundër aplikimit të dënimeve me vdekje dhe torturave fizike dhe në vend të tyre propozonin izolimin, vetmimin e të dënuarve. Sipas pikëpamjeve të kësaj sekte, personi i dënuar, duke qëndruar i izoluar dhe i vetmuar, ka kohë të mendojë për veprën dhe sjelljet e tij kriminale. Në këtë mënyrë, atij i jepet shansi për t'u penduar për veprimet kriminale dhe për t'u përmirësuar në pikëpamje morale. Sipas këtyre pikëpamjeve, të gjithë të dënuarit duhet të vendosen nëpër kthina të veçanta, nëpër qeli dhe të qëndrojnë të vetmuar një kohë të caktuar dhe në këtë mënyrë të pendohen për krimin që kanë bërë. Në literaturën penologjike përmenden dy variante të këtij sistemi: sistemi klasik i qelisë dhe sistemi i heshtjes apo i Obernit.¹¹

¹⁰ Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2011, faqe 102-103.

¹¹ Po aty, faqe 105.

3. Sistemi klasik i qelisë

Personi i dënuar sipas këtij sistemi, nuk ka pasur kurrëfarë kontakti me botën e jashtme. Ai ka qëndruar i izoluar në qelin dhe ka pasur rast që për krimin e bërë të meditojë dhe të pendohet. Gjithashtu, personi i dënuar sipas këtij sistemi, ka mundur që herë pas here të ketë kontakt me personelin e burgut-entit apo priftin dhe të shfrytëzojë literaturë religjioze për të lexuar në kohë të caktuar. Izolimi në këtë sistem ka qenë religjioz. Këta persona, nuk kanë pasur kontakt me persona të tjerë të dënuar. Sistemi i izolimit të plotë, ka hasur në kritika dhe vërejtje të ndryshme. Në literaturë flitet për përparësitë dhe të metat e këtij sistemi. Si përparësi e veçantë e këtij sistemi është theksuar fakti se me të bëhet pengimi i ndikimit negativ të personave të dënuar në njëri-tjetrin, evitohet mundësia e ikjes, eliminohen mundësitë e trazirave dhe kryengritjeve të të dënuarve. Mirëpo, në anën tjetër, theksohet se, këtë sistem e kanë përcjellë edhe shumë të meta. Në rend të parë, izolimi i të dënuarit për një kohë të gjatë në qeli, ka shkaktuar pasoja të rënda në shëndetin psikik dhe fizik të tij. Izolimi nuk ka nxitur përmirësimin por, shpeshherë demoralizimin dhe traumat psikike të personalitetit të të dënuarit. Personat e dënuar duke qëndruar një kohë të gjatë në qeli, pësojnë atrofi dhe çrregullime të shumta vetive dhe funksioneve psikike e fizike. Duke qëndruar të izoluar në qeli, ata nuk përgaditen për jetën në liri. Në literaturë theksohet se shumë persona të dënuar gjatë qëndrimit nëpër ente të sistemit të qelisë, kanë përjetuar kriza dhe çrregullime të rënda shpirtërore. Gjithashtu, qëndrimi në burg për shumë delikuentë është bërë faktorë kriminogjen. Kjo dukuri, në Penologji quhet përshtatje e jetesës në burg ose prizonizim.¹²

4. Sistemi i heshtjes

Sipas këtij sistemi, personat e dënuar natën, qëndrojnë të ndarë nga njëri-tjetri dhe të izoluar plotësisht, ndërsa, gjatë ditës ata dërgohen në punë dhe aty u jepet mundësia të dalin nga izolimi, të punojnë së bashku me të dënuarit e tjerë. Mirëpo, gjatë kohës në punë dhe shkuarjes-ardhjes në punë, ata e kanë pasur të ndaluar çdo bisedë dhe komunikim. Mos respektimi i ndalesës së komunikimit dhe obligimit të heshtjes, është dënuar në mënyrë rigoroze nga personeli i institucionit. Për këtë arsye, ky sistem e ka marrë emrin sistemi i heshtjes ose “silent system”, se personat e dënuar kanë qenë të detyruar të heshtin tërë kohën sa kanë qëndruar së bashku.

Ndalimi i komunikimit të bisedës dhe obligimi i të dënuarve që të heshtin, është bërë, me qëllim të pengimit “të infektimit kriminal” në mes tyre. Mirëpo, edhe këtij sistemi i bëhet vërejtje, në rend të parë për shkak të obligimit të heshtjes së personave të dënuar dhe ndëshkimit rigoroz të shkeljes së tij. *Njeriu, si qenie e vetëdijshme sociale, komunikimin me të tjerët e ka si pjesë të*

¹² Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2011, faqe 106-107.

pandarë të jetës dhe formimit të tij. Për shkeljet e këtij obligimi, ata janë dënuar në mënyra të vrazhda, me rrahje dhe tortura të ndryshme fizike dhe me kufizimin e disa të drejtave elementare.

Si burgje dhe ente të njohura, të organizuara sipas këtij sistemi, në SHBA përmendet burgu i njohur “Sing-sing” në qytetin Çarlston. Ndërsa, në vendet evropiane, është i njohur sistemi i burgut të këtille në Gjenevë dhe në Lozanë të Zvicrës. Mirëpo, për shkak të dobësive dhe vërejtjeve të cilat u panë, ky sistem nuk ka qëndruar një kohë të gjatë, prandaj, në praktikë ka pësuar transformime dhe reforma.¹³

5. Sisitemi progresiv

Karakteristika themelore e këtij sistemi qëndron në faktin se personi i dënuar gjatë mbajtjes së dënimit me burgim, prej momentit të ardhjes në ent e deri sa të dal në liri, ka mundësi që të ndërrojë pozitën e vet dhe atë në mënyrë graduale, varësisht prej angazhimit në punë dhe sjelljes së tij. Ai gjatë mbajtjes së dënimit, kalon nëpër disa faza në mënyrë progresive duke ndryshuar pozitën e vet. Në fillim ai vendoset në burgun e qelisë, pra, në sistem të izolimit të plotë. Mbas një kohe, nëse janë bërë ndryshime pozitive, i dënuari kalon në burgun e përbashkët ose kolektiv. Në burgun kolektiv ai kyçet në procesin e punës dhe në këtë mënyrë ka mundësi që me angazhimin e vet të ndikojë në pozitën e tij si i dënuar. Nëse këtë fazë e kalon me sukses dhe të personeli i institucionit krijohet një bindje se dënimi ka pasur efekte pozitive në përmirësimin e tij, ai kalon në fazën vijuese e cila është mjaft e favorshme. Faza vijuese mund të jetë lirimi me kusht ose qëndrimi në të ashtuquajturën paralele për të lirë, e pastaj lirimi me kush.¹⁴

6. Sistemi progresiv anglez

Sipas sistemit angles, gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim, të dënuarit kalojnë nëpër tri faza kryesore:

Faza e parë e mbajtjes së dënimit me burgim, sipas këtij sistemi, është faza e qëndrimit në qeli, përkatësisht faza e izolimit të personave të dënuar në vetmi. Në këtë fazë, të dënuarit mbyllen në qeli, nuk kanë kurrëfarë kontakti me të burgosurit tjerë e as me botën e jashtme.

Faza e dytë e sistemit progresiv anglez qëndron në mbajtjen e përbashkët të dënimit me burgim. Në këtë fazë, personat e dënuar gjatë ditës, punojnë së bashku me personat e tjerë të dënuar, pa obligim të heshtjes. Të dënuarit mund të komunikojnë lirisht gjatë procesit të punës, ndërsa natën, të dënuarit qëndrojnë të izoluar në qeli të veçanta.

¹³ Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2011, faqe 107-108.

¹⁴ Po aty, faqe 109-110.

Faza e tretë e sistemit progresiv anglez qëndron në lëshimin me kusht të dënuar. Kjo do të thotë se personat e dënuar tani lirohen para kohe dhe dalin në liri pa mbajtur tërë dënimin e paraparë sipas vendimit gjyqësor. Lirimi me kusht do të thotë që, personat e dënuar, edhe pse lirohen para kohe nga burgu, kanë edhe më tej obligime për mirësjellje dhe respektim të ligji. Ata, faktikisht, konsiderohen si të dënuar dhe se në liri janë duke u sprovuar.¹⁵

7. Sistemi progresiv irlandez

Ky sistem për dallim nga sistemi anglez, gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim, të dënuarit kalojnë nëpër katër faza: faza e qelisë, faza e burgut të përashkët, faza e qëndrimit në paralele për të lirë dhe fazën e lëshimit me kusht në liri. Themeluesi i këtij sistemi konsiderohet mendimtari Walter Grafton, anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e institucioneve Ndëshkimore në Irlandë. Ai propozon që personat e dënuar, të cilët e mbajnë dënimin sipas sistemit progresiv anglez, para se të lirohen me kusht duhet të vendosen në një objekt të veçantë ku kushtet e jetës dhe punës janë krejtësisht tjera nga ato të personave që gjenden në fazën e burgut të përbashkët.¹⁶

8. Sistemi i pikëve ose i Makonakut

Ky sistem ka disa veti dhe elemente të sistemit progresiv. Edhe këtu parashikohen disa faza nëpër të cilat duhet të kalojë personi i dënuar gjatë mbajtjes së dënimit me burgim. Mirëpo, Makonaku nuk i ka emëruar dhe nuk e ka përcaktuar kohën e saktë të qëndrimit në këto faza të veçanta. Sipas sistemit të poenave apo pikëve, në fazën e parë, personat e dënuar zakonisht i nënshtrohen një disiplinë të rreptë. Mirëpo, për dallim nga sistemi progresiv, personat e dënuar, këtu qëndrojnë të izoluar dhe gjatë kësaj kohe kanë disa obligime të cilat duhet t'i respektojnë me përpikshmëri. Në **fazën e parë** ata kanë qenë të detyruar të punojnë. Në **fazën e dytë** të këtij sistemi, personave të dënuar u mundësohej të ndahen në grupe pune. Këto grupe pune ishin të vogla, nga pesë-gjashtë të dënuar. Personave të dënuar u mundësohej që vetë të bënin formimin dhe zgjedhjen e grupit të punës. Për secilin grup të të dënuarve, caktohej numri i poenave a i pikëve që duhej të përmbushte. Në **fazën e tretë**, grupi i të dënuarve shpërndahej dhe secili person i dënuar tani fitonte një shtëpizë të veten me një sipërfaqe të caktuar të tokës, ku ai mund të mirrej me punë bujqësore duke kultivuar prodhime të ndryshme.¹⁷

¹⁵ Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2011, faqe 110-112.

¹⁶ Po aty, faqe 113.

¹⁷ Po aty, faqe 114-116.

9. Sistemi i klasifikimit ose i Gjenevës

Quhet sistem i Gjenevës për arsye se për herë të parë u aplikua në Gjenevë të Zvicrës, ndërsa cilësohet i klasifikimit, ngase këtu u vërejt një përpjekje më serioze dhe më e organizuar për ndarjen dhe klasifikimin e personave të dënuar në grupe, nëngrupe, klasë e paralele, me qëllim të riedukimit dhe përmirësimit më të suksesshëm. Edhe në këtë sistem, personat e dënuar, gjatë mbajtjes së dënimit me burgim, kalojnë nëpër tri faza kryesore:

Faza e parë ose e qelisë, është gati identik në fazën e njëjtë në sistemin progresiv anglez. Personat e dënuar duhet ta kalojnë një kohë të mbajtjes së dënimit në qeli të izoluar dhe me një tretman të veçantë.

Faza e dytë është më interesante. Në këtë fazë, personat e dënuar ndahen dhe klasifikohen në grupe, nëngrupe, klasë dhe paralele. Kjo ndarje apo ky klasifikim bëhet në bazë të kriterëve dhe rrethanave të ndryshme. Klasifikimi dhe ndarja e personave të dënuar bëhet me qëllim të eliminimit të ndikimit negativ të dënuarve të një kategorie ndaj të dënuarve të kategorisë tjetër. Klasifikimi bëhet sipas veprave penale, lartësisë së dënimit, shkallës së përgjegjësisë, motivit të kryerjes dhe recidivizmit. Ndërsa, më vonë me depërtimin e mësimëve dhe ideve të shkollave kriminologjike e posaçërisht shkollës pozitiviste italiane dhe shkollës të mbrojtjes së re shoqërore, si kriter merren edhe një varg vetish të natyrës subjektive. Në këtë mënyrë, tani lidhur me ndarjen dhe klasifikimin e personave të dënuar, merret parasysh personaliteti i të dënuarit dhe vetitë e tij fizike dhe psikike. Sidomos, merren në konsiderim motivet, shprehitë, temperamentit, emocionet dhe vetitë tjera

Faza e tretë e sistemit të Gjenevës ka pasur të bëjë me lirimin e personave të dënuar para kohe. Fjala është për lirimin me kusht të personave të dënuar të cilët me sukses i kanë kaluar të gjitha sprovat e fazave të mëparshme dhe tani vlerësohet se ata janë përmirësuar dhe nuk ka rrezik që të përsërisin veprën penale.¹⁸

10. Sistemi modern ose bashkëkohor

Sistemi modern bashkëkohor, shfrytëzon dhe elaboron idetë dhe pikëpamjet e përfaqësuesve të shkollës së Mbrojtjes së re shoqërore. Sipas këtyre ideve, nëpër ente ndëshkimore përmirësuese duhet të bëhet një klasifikim i gjithanshëm i personave të dënuar, të bëhet ndarja e të dënuarve nëpër grupe e nëngrupe duke përcaktuar për secilin vende dhe kushte të veçanta të jetës dhe të punës. Angazhimi i personave të dënuar në procesin e punës, bëhet me qëllim të aftësimit dhe të përsosjes së tyre për mjeshtri dhe zanate të ndryshme me qëllim që kur të dalin në liri, të kyçen në jetë pa probleme. Për tu mbrojtur nga kriminaliteti, shoqëria duhet që patjetër, sipas sistemit modern, t'i klasifikojë personat e dënuar. Ndaj personave të dënuar që kanë treguar rrezikshmëri të

¹⁸ Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2011, faqe 117-118.

veçantë, ndaj recidivistëve dhe ndaj të dënuarve të papërmirësueshëm, duhet aplikuar një terapi dhe tretman i veçantë. Sistemi modern i ekzekutimit të dënimit me burgim nuk do të thotë se është ndonjë sistem unik dhe i njëjtë në të gjitha shtetet ku aplikohet. Sistemi bashkëkohor apo modern aplikon disa faza karakteristike:

Faza e parë, sipas sistemit modern, fillon me vrojtimin dhe studimin e personit të dënuar. Personi i dënuar gjatë kësaj faze, i nënshtrohet një studimi dhe analize të një ekipi të ekspertëve të lëmenjve të ndryshëm shkencor. Duke aplikuar njohuritë shkencore nga lëmia e psikologjisë, sociologjisë, kriminologjisë, pedagogjisë dhe disiplinave të tjera, bëhet një njohje e tërësishme e personalitetit të të dënuarit. Në këtë mënyrë, personaliteti i të dënuarit incizohet nga të gjitha aspektet pastaj, propozohet tretmani i cili duhet aplikuar ndaj tij. Kjo fazë është shumë e rëndësishme, sepse nëse me sukses bëhet njohja, analiza dhe ndriçimi i personalitetit të të dënuarit, atëherë edhe procesi i riintegritimit do të jetë më i lehtë dhe më i suksesshëm.

Faza e dytë, e sistemit modern-bashkëkohor, është më shumë e gërshetuar me një klasifikim të gjerë të personave të dënuar. Personat e dënuar sikurse edhe në sistemin progresiv, edhe tani mund të ndikojnë dukshëm në përmirësimin e pozitës së tyre në ent. Me interesim, me angazhim, me punë, me përsosje dhe aftësim profesional, ata vetë mund të krijojnë kushte për të fituar një varg të drejtash dhe beneficimesh. Këto të drejta mund të jenë: e drejta për vizita, e drejta të dalë jashtë institucionit, e drejta për të vazhduar shkollimin e mesëm apo universitar, e drejta për shpërblim më të madh për punë, e drejta në pushime të jashtëzakonshme e deri te lëshimi me kusht para se të kalojë afati i dënimit.

Faza e tretë e sistemit modern është lëshimi me kusht dhe ndihma postpenale ndaj të dënuarve. Lëshimi me kusht, sipas këtij sistemi, është mjaft i ngjajshëm me sistemin progresiv irlandez. E vetmja risi në sistemin modern qëndron në faktin se tani, personave të dënuar të cilët lëshohen me kusht, u ofrohet një ndihmë dhe kujdes i veçantë, që ka të bëjë me sigurimin e punës, sigurimin e vendosjes, mbrojtjen shëndetësore dhe ndihma të tjera të cilat kanë për qëllim stabilizimin e tyre dhe pengimin e përsëritjes së sjelljeve kriminale.¹⁹

3. KARAKTERISTIKAT E DËNIMIT ME BURG PËR VRASJE TË RËNDA

Duke u nisur nga elementet konstitutive si dhe funksionimin që duhet ta ushtrojë dënimi, e drejta penale bashkëkohore i përcakton edhe disa karakteristika, apo tipare që duhet të përmbushen me rastin e shqiptimit dhe zabtimit të tij. Këto tipare themelore të dënimit konsistojnë në sa vijon:

¹⁹ Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2011, faqe 119-121.

a) **Dënimi duhet të jetë personal.** Ndryshe nga të drejtat penale primitive, sipas të cilave dënimi e ka goditur jo vetëm kryerësin e verës penale por edhe të afërmit e tij, anëtarët e familjes apo të fisit të tij, sipas të drejtave penale bashkëkohore, dënimi duhet të jetë personal. Kjo do të thotë që dënimi duhet ta godas vetëm kryerësin e veprës penale, e jo edhe personat e tjerë. Mirëpo, duhet theksuar se përkundër këtij parimi dhe synimeve të politikës ndëshkuese bashkëkohore që të përmbushet ky kusht, që dënimi duhet të jetë personal, ta godasë vetëm kryerësin e veprës penale, edhe tani pothuaj çdo dënim në një formë dhe masë godet edhe personat tjerë, sidomos anëtarët e familjes dhe të afërmit e tjerë të fajtorit. Për shembull, pasojat negative të dënimit janë të pashmangshme në rastin kur i ati i fëmijëve kryen veprën penale dhe dënohet. Pasojat negative, ato materiale, psikologjike e të tjera, gjithsesi në një formë dhe masë i godasin fëmijët, bashkëshorten, madje edhe të afërmit tjerë²⁰.

b) **Dënimi duhet të jetë human.** Kjo do të thotë se dënimi nuk guxon të paraqet mundim dhe përbuzje të delikuentit, si dhe nuk guxon të shkaktojë dëmtimin e shëndetit të tij. Në këtë drejtim konventat ndërkombëtare, Kodi i Procedurës Penale dhe ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale garantojnë respektimin e personalitetit dhe dinjitetin e njeriut në procedurën penale dhe gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit. Gjithashtu, edhe disa konventa ndërkombëtare, që u referohen lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, siç janë Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut dhe Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike, parashohin edhe norma me të cilat kërkohet që dënimi të jetë human²¹.

c) **Dënimi duhet të jetë legjitim.** Rrjedhimisht për të qenë dënimi human, ai duhet të jetë edhe legjitim. Dënimi është legjitim vetëm nëse gjyqi shqipton asi lloji dhe lartësie të dënimit, i cili është i domosdoshëm për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti dhe për përmirësimin e fajtorit. Lidhur me këtë është mjaft impresiv konstatimi vijues: “Një represion, që nuk është i preokupuar me resocializimin e delikuentit, bën një punë të kotë dhe johumane”. Përkatësisht, nëse shqiptohen dënime drakoniane, të cilat në masë të theksuar kanë primesa retributive dhe shprehin hakmarrje, madje dhe urrejtje ndaj delikuentit, atëherë ato dënime nuk janë legjitime dhe në brendinë e tyre janë edhe kundërligjore²².

d) Brenda suazave ligjore që lejojnë individualizmin e dënimit, dënimi duhet t'i godasë njësoj kryerësit e veprave penale, pa marrë parasysh përkatësinë nacionale, fetare, racore, politike,

²⁰ Salihu. Ismeti, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2012, faqe 423.

²¹ Po aty, faqe 424.

²² Po aty, faqe 424.

sociale etj. Kjo tipare e dënimit në fakt konsiston në realizimin e parimit të egalitetit (barazisë) së qytetarëve para ligjit dhe gjyqit dhe në realizimin e politikës ndëshkuese unike. Kjo çështje është posaçërisht e rëndësishme në të drejtën penale bashkëkohore, sepse në legjislacionet penale në fuqi sanksionet penale, në kuadrin e tyre edhe dënimet, janë ashtu të parapara sa që gjyqeve u japin autorizime të mëdha lidhur me zgjedhjen e llojit dhe masës së dënimit që mund t'i shqiptohet kryerësit të veprës penale. Kjo tipare implikon në vete kërkesën që kryerësit e veprave penale identike të dënohen me dënime identike. Në të kundërtën, nëse vijnë e shprehen zgjidhje kontraktore në fushën e politikës ndëshkuese ndër aktgjykime të të njëjtit gjyq apo të gjyqeve të viseve të ndryshme të shtetit, për të njëtat vepra të kryera nga kryerës të ngjajshëm, atëherë ky është shembull tipik i pabarazisë së qytetarëve në jurisprudencën penale²³.

e) Dënimi duhe të jetë proporcional me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të kryerësit. Me këtë tipare përmbushet edhe postulati i drejtësisë së dënimit. Përpjestueshmëria dhe drejtësia e dënimit shprehet duke marrë parasysh jo vetëm peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale, por edhe rrethanat e tjera objektive dhe subjektive, siç janë p.sh. jeta e mëparshme e kryerësit, sjellja pas kryerjes së veprës, qëllimet gjenerale dhe speciale të dënimit etj²⁴.

f) Dënimi duhe të jetë i ndarë. Dënimi është i ndarë nëse ai mund të shqiptohet në masë më të vogël apo më të madhe, varësisht nga pesha e veprës penale, rrethanat në të cilat ajo është kryer dhe rrezikshmërisë së kryerësit të veprës. Kjo tipare shprehet te dënimi me heqje të lirisë dhe të dënimit me të holla, por jo edhe te dënimi me vdekje²⁵

g) Dënimi duhe të jetë i revokueshëm. Përkatësisht, në rastet kur konstatohet se dënimi është shqiptuar në kundërshtim me ligjin, për shkak të lajshimit të gjyqit apo provave të rrejshme, ai duhet të abrogohet. Edhe kjo tipare nuk mund të shprehet te dënimi me vdekje, nëse është bërë ekzekutimi i tij²⁶.

h) Dënimi duhe të jetë i përmirësueshëm. Edhe kjo tipare duhet të shprehet në rastet kur dënimi është shqiptuar në kundërshtim me ligjin për shkak të dëshmisë së rrejshme apo ndonjë rrethanë tjetër. Dënimet pasurore janë të përmirësueshme, mirëpo dënimi me vdekje, nëse është

²³ Salihu. Ismeti, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2012, faqe 424.

²⁴ Po aty, faqe 424-425.

²⁵ Po aty, faqe 425.

²⁶ Po aty, faqe 425.

ekzekutuar, nuk mund të përmirësohet. Gjithashtu, për shkak të pasojave të shumta dhe të natyrës së ndryshme, sipas shumicës së shkencëtarëve të së drejtës penale, edhe dënimi me burg, i cili pjesërisht apo në tërësi është ekzekutuar, nuk mund të përmirësohet, ngase të dënuarit nuk mund t'i kthehet liria gjatë asaj kohe sa ka qëndruar në burg. Kompensimi në të holla, që zakonisht jepet për këso raste, më tepër ka karakter të dëmshpërblimit material, dëmshpërblim ky i cili nuk mund t'i eliminojë të gjitha pasojat e shkaktuara të dënimit me burg²⁷.

4. QËLLIMI I DËNIMIT ME BURG SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Si në të gjitha sistemet penitensiare bashkëkohore ashtu edhe në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë qëllimi i dënimit me burg apo heqje të lirisë është larg idesë së ndëshkimit dhe hakmarrjes ndaj kryerësit dhe pikërisht atë e parasheh në mënyrë decise dhe qëllimin e dënimit me burg në kodin penal të RM-së ku kemi nenin 32 si vijon²⁸:

- 1) pengimi i kryerësit të kryej veprë penale dhe riedukimi i tij , dhe
- 2) në mënyrë edukative të ndikoj ndaj të tjerëve të mos kryejnë vepra penale.

Prej këtu kuptojm se në rradhë të parë si qëllim kryesorë është realizimi i drejtësisë si parim kryesor dhe fundamental, mbrojtja e lirisë dhe të drejtave themelore dhe mbrojtja e shoqërisë nga krimet dhe veprat penale. Sipas KPM-së si qëllime kryesore të dënimit me burg apo heqjes të lirisë nënkuptojmë apo kemi preventivën speciale, preventivën gjenerale dhe realizimi i drejtësisë.²⁹ Preventiva speciale lidhet me kryerësin delikuent i cili ka kryer veprë penale dhe qëllimi i saj është që i njejtë të pengohet në vazhdimin apo kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale dhe qëllimin që i njejtë duhet t'i nënshtrohet procesit të risocializimit apo riedukimit që të përsoset, edukohet dhe bindet për veprat e kryera me qëllim të vazhdimin të jetës normale. Pengimi i delikuentit realizohet duke e frikësuar për sjelljet e tij që në të ardhmen mos jetë pjesë e shkelësve të ligjit apo rregullave, nëpërmjet izolimit duke e neutralizuar me çka arrihet distancimi i tij nga krimet e mundshme dhe mbrojtja e caktuar e shoqërisë apo individëve nga kriminaliteti.

²⁷ Salihu. Ismeti, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2012, faqe 425.

²⁸ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 32.

²⁹ Po aty.

Risocializimi apo riedukimi është qëllim kryesorë i KPM-së pasi ajo respekton parimet themelore dhe idenë se heqja e lirisë e personit të caktuar nuk paraqet ndëshkim e as hakmarrje për veprën e kryer por vetëm pendim, edukim dhe adaptim të dënuarit që arrihet me anë të procesit të risocializimit. Me procesin e risocializimit personi i dënuar gjatë qëndrimit në entin përkatës aftësohet, përmirësohet, edukohet që të ngrit vetëdijen personale dhe të jetë në gjendje dhe i gatshëm për respektimin e normave shoqërore, gjegjësisht rregullave normative dhe pavarësinë e kthimit në bashkësinë shoqërore si qytetar i rëndomtë dhe të jetë në gjendje që vet të siguroj ekzistencën duke punuar ndershmërisht. Pasi delikuenti ka kryer veprën penale dhe ka shkelur rregullat normative me sjelljet e tij kriminale, atëherë nëpërmjet procesit të riedukimit në ent apo në organin përkatës mundohet të arrihet bindja dhe edukimi me qëllim të respektimit të normave dhe rregullave shoqërore që në të ardhmen mos t'i shkel të njejtat. Praktika e deritanishme tregon edhe të kundërtën apo mos arritjen e këtij procesi të risocializimit ndaj të dënuarve nga natyra komplekse e këtij fenomeni ku si rezultat kemi paraqitjen e recidivizmit, ku me recidivizëm nënkuptojmë se vepra penale është kryer nga delikuent veç më i dënuar më parë për vepër tjetër penale gjegjësisht përsëritjen e veprës penale nga i njëjti person. Preventiva gjenerale përveç dënimit ndaj kryerësit qëllimi i saj është frikësimin apo edukimin e të tjerëve përkatësisht delikuentët potencial për të mos kryer vepra penale.

Nga vet ekzistimi i kodit penal sigurohet sanksionimi i kryerësit, përndjekja efikase dhe ekzekutimit të dënimit me çka arrihet qëllimi i frikësimit dhe ndikimi edukativ-moral. Mbjellja e frikës në publikun e gjërë arrihet me vet sanksionimin që të gjithë qytetarët apo delikuentët potencial t'i zmbarsen kryerjes të veprave penale të mundshme pasi edhe ato mund t'i gjejë një e keqe që ka gjetur të dënuarin, pra arrihet frikësimi kolektiv. Përveç qëllimit të frikësimit, me anë të preventivës gjenerale synim tjetër është edhe ndikimi edukues, ngritjen dhe përforcimin e moralit që do të arrij deri te garantimi për respektimin e rregullave normative dhe stabilitetin në rrethin shoqëror.

Qëllimi i dënimit me burg në RM-së është i rregulluar edhe me ligjin për ekzekutimin e sanksioneve me nenin 37 si vijon³⁰;

1) Qëllimi i ekzekutimit të dënimit me burg është aftësim i personave të gjykuar që të kyçen në shoqëri me gjasa më të mira për jetë të pavarur në pajtim me ligjin.

2) Për shkak të arritjes së qëllimit të ekzekutimit të dënimit me burg te personat e dënuar zhvillohet ndjenja e përgjegjësisë dhe nxiten që ta pranojnë dhe në mënyrë aktive të marrin pjesë në trajtim gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, të motivuar dhe të drejtuar në riedukim dhe zhvillim të cilësive pozitive të karakterit dhe aftësive që shpejtojnë kthimin e suksesshëm në shoqëri.

³⁰ Osmani.Afrim,Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve,Shkup,2013,faqe 64.

Për realizimin e qëllimeve të dënimit sipas kodit penal të RM-së janë matja gjyqësore e dënimit duke e bazuar të njëjtin mbi parimet e individualizimit dhe ligjshmërisë, vuajtjen e dënimit dhe ndihmën postpenale që i jepet të dënuarit pas vuajtjes së dënimit.

5. DËNIMI ME BURG SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Me dënimin me burg kuptojmë heqjen e lirisë në mënyrë të dhunshme kryerësit penalisht të përgjegjshëm nga ana e gjykatës në procedurë të rregullt gjyqësore dhe në afat kohor të caktuar. Edhe në sistemin tonë dhe praktikën gjyqësore bëhen përpjekje për kufizimin, përmirësimin dhe avansimin e këtij dënimi që të arrihet arsyeshmëria e shkallës më të lart nga shkak i kompleksitetit apo rëndësisë të këtij dënimi. Duke u nisur nga respektimi i parimit të humanizmit për dënimin me burg dhe afrimin me idetë dhe praktikën e shteteve bashkëkohore evropiane, sistemi jonë këtë lloj dënimi e rregullon në mënyrë ligjore në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë. Teoria e shumë shteteve se dënimi me kohëzgjatje të shkurtër nuk është i dëshiruar dhe jo i dobishëm pasi me të nuk arrihet qëllimi kryesorë procesi i risocializimit dhe riedukimit të kryerësit për shkak të kohës e cila nuk është e mjaftueshme, edhe sistemi i Republikës së Maqedonisë është përkrahëse kësaj ideje dhe e praktikon në legjislacionin dhe praktikën gjyqësore³¹. Në krahasim me disa sisteme që parashohin dënim edhe prej një dite që nuk është e preferuar në sistemin tonë, ku kjo çështje është e rregulluar me kodin penal të Republikës së Maqedonisë në nenin 35, ku thuhet se dënimi me burg nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë.

Sipas kodit penal të Republikës së Maqedonisë dënimet ndahen në dënime primare dhe dënime sekondare.³² Dënimet primare janë dënimi me burgim dhe dënimi me të holla, kurse si dënime sekondare janë ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës, ndalimi i drejtimit të automjetit dhe dëbimi i të huajt nga vendi. Dënimi me burg apo heqjes lirisë bën pjesë në dënimet kryesore bashkë me dënimin me të holla. Dënimi me burg mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesorë apo primar për dallim nga dënimi me të holla që mund të shqiptohet edhe si dënim primar edhe sekondar kur shqiptohet bashkë me dënimin me burg.

Në nenin 35 të Kodit Penal të RM-së janë të parapara dhe të rregulluara të gjitha format ligjore dhe afatet kohore të këtij dënimi. Për sa i përket afatit apo kohëzgjatjes së këtij dënimi kemi minimumin dhe maksimumin ku sipas nenit 35 paragrafi 1 të KPM-së dallojmë burg të kufizuar, burg afatgjatë dhe burg të përjetshëm. Minimumi ligjor i dënimit është 30 ditë kurse maksimumi

³¹ Kambovski.Vllado,E drejta penale,Shkup,2007,faqe 478.

³² Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë,neni 35.

deri 20 vjet, për veprat e rënda penale që është paraparë dënim me burg të përjetshëm mund të shqiptohet dënim me burg prej 40 vjetëve, derisa për veprat e kryera me dashje është paraparë dënim deri 20 vjet për format e rënda dhe të paramenduara të asaj vepre mund të caktohet edhe burgim i përjetshëm. Dënimi me burg të përjetshëm për herë të parë në legjislacionin tonë të Maqedonisë paraqitet në vitin 1996 si zëvendësim nga heqja dënimit me vdekje dhe plotësimin e zbrasëtirës juridike. Ky dënim nuk mund të caktohet si dënim i vetëm kryesorë, që del se mund të shqiptohet si dënim alternativ bashkë me dënimin kryesorë që është dënimi me burg deri 20 vjet si dhe ai deri në 40 vjet burg i rregulluar me nenin 35 të KPM-së. Duke respektuar dhe mbrojtur parimet themelore ligji në mënyrë të qartë cakton se dënimi me burg të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personave apo kryerësve të veprave penale të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i kanë mbushur 21 vjet. Pra në këtë rast gjyqi lirisht mund të zgjedh dënim qoftë edhe mbi maksimumin ligjor që është 20 vjet por asesi burg të përjetshëm. Edhe pse personi 21 vjeçar ka kaluar adoleshencën përsëri llogaritet si madhor i ri dhe përgjegjësia e tij për rastet e rënda është diskutabile. Dënimi me burg shqiptohet në vite dhe muaj të plotë, kurse dënimet më të lehta që mund të jenë deri në gjashtë muaj edhe në ditë të plota,(n.35.p.6.KPM)³³. Kur maksimumi i dënimit nuk është më i lartë se 3 vite ndërsa minimumi nuk është caktuar atëherë bashkë me dënimin me burg shqiptohet edhe dënimi me të holla. Dënimi me burg shqiptohet nga gjykata në procedurë të rregullt ligjore dhe pas respektimit të afateve ky dënim vihet në institucionet përkatëse për vuajtjen e dënimit të përcaktuar me ligj (neni 35.p.7 KPM)³⁴.

Institucionet për vuajtjen e dënimit ndahen në dy lloje, të hapura dhe të mbyllura. Për respektimin e lirive dhe të drejtave të dënuarve, Republika e Maqedonisë në vitin 1997 në sistemin e saj juridik përfshin edhe standardet ndërkombëtare si ato të OKB-së që janë “rregullat standarde minimale për sjellje me të burgosur” si dhe rregullat evropiane të burgut nga Komiteti i Ministrave të KE-së nga viti 1982. Klasifikimi i të dënuarve në institucionet përkatëse shtetërore bëhet sipas gjinisë, moshës, kohëzgjatjes së dënimit dhe nevojës së sigurisë nga largimi për mundësin e ikjes të dënuarve.

³³ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 35.

³⁴ Po aty, neni 35.

6. RREGULLAT MINIMALE STANDARDE TË OKB-SË, PËR TRAJTIMIN E TË BURGOSURVE

Regjistri

1. Në çdo vend ku mbahen njerëz të burgosur duhet të mbahet një rregjistër i lidhur dhe me numërim faqesh ku për çdo të burgosur të shënohet:

- a) Identiteti i tij
- b) Arsyet e burgimit të tij dhe organi kompetent që ka vendosur për këtë
- c) Dita dhe ora e hyrjes dhe e daljes.

2. Asnjë person nuk duhet të hyjë në një burg pa një vërtetim të rregullt ku të tregohet arsyeja e burgimit të tij, hollësisht e të cilit duhet të jenë parashtruar më parë në rregjistër³⁵.

Ndarja e kategorive

Kategoritë e ndryshme të të burgosurve duhet të vendosen në burgjet ose sektorë burgjesh të ndryshëm, sipas gjinisë, moshës, rasteve e ndodhive të mëparshme në jetën e tyre, të arsyeve të burgimit dhe të kërkesave të trajtimit të tyre. Rrjedhimisht³⁶:

- a) Burrat dhe gratë duhet të mbahen sipas mundësive në godina të ndryshme: në një godinë ku mbahen burrat edhe gra të gjitha lokalet që u shërbejnë grave duhet të jenë krejt të ndara.
- b) Të ndaluarit e paraburgosur duhet të jenë të ndarë nga të dënuarit.
- c) Personat e burgosur për borxhe ose të dënuar për të vuajtur një formë burgimi për çështjen civile duhet të jenë të veçuar nga të burgosurit për çështje penale.
- d) Të burgosurit në moshë të re duhet të jenë të veçuar nga ata në moshë të rritur.

Lokalet e burgut

1. Qelitë ose dhomat e caktuara për izolimin gjatë natës nuk duhet të kenë më shumë se një të burgosur. Në qoftë se, për arsye të veçanta, si për shembull ngushticë e përkohshme, është e nevojshme që administrata qendrore e burgut të bëjë përjashtime nga ky rregull, do të duhet të evitohet që të strehohej dy veta për çdo qeli ose dhomë individuale.

2. Në raste kur ka fjetore, këto duhet të strehojnë të dënuar të zgjedhur me kujdes dhe të njohur si të përshtatshëm për t'i vendosur në kushte të tilla. Gjatë natës ata do t'i nënshtohen një mbikëqyrje të rregullt, e cila duhet t'i përshtatet tipit të burgut³⁷.

³⁵ Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2010, faqe 284.

³⁶ Po aty.

Higjena personale

1. Të burgosurit duhet t'u kërkohet që të mbajnë pastërtinë personale; për këtë duhet t'u sigurohet ujë dhe artikujt e tualetit të nevojshëm për shëndetin dhe pastërtinë e tyre.

2. Me qëllim që të burgosurit të mund të kenë një paraqitje të përshtatshme dhe të ruajnë respekt për veten e tyre, duhet të sigurohen disa lehtësi për mirënjohjen e flokëve dhe të mjekrës; burrat duhet të kenë mundësi të rruhen rregullisht³⁸.

Veshmbathja dhe shtresat

1. Çdo i burgosur që nuk është i autorizuar të mbaj veshjen e vet vetjake duhet të pajiset me një veshje që t'i përshtatet klimës dhe t'i mjaftojë për të mbajtur atë në shëndet të mirë. Kjo veshje nuk duhet të jetë në asnjë mënyrë degraduese ose poshtëruese.

2. Të gjithë veshjet duhet të jenë të pastra dhe në gjendje të mirë. Veshjet e brendëshme duhet të ndërrohen e të lahen aq shpesh sa është e nevojshme për ruajtjen e higjenës.

3. Në rastet e jahtëzakonshme kur i burgosuri del nga burgu për ndonjë qëllim të autorizuar, atij duhet t'i lejohen të lejë veshjen e tij vetjake, ose një veshje që të mos tërheqë ndonjë vëmendje të veçantë.

Çdo i burgosur duhet të ketë në dispozicion, në përputhje me zakonet lokale ose nacionale, një shtarat të vet individual si dhe shtresa të veta të mjaftueshme, të mbajtura mirë dhe të përtërirat me qëllim që të sigurohet pastërtia³⁹.

Ushqimi

1. Çdo i burgosur duhet të marrë nga administrata në orët e zakonshme një ushqim të cilësisë së mirë, të përgatitur dhe të shërbyer mirë dhe që të ketë një vlerë ushqimore të mjaftueshme për të ruajtur shëndetin dhe forcat.

2. Çdo i burgosur duhet të ketë mundësi të siguroj ujë të pijshëm kurdoherë që ka nevojë⁴⁰.

Shërbimet mjekësore

1. Çdo institucion penitenciar duhet të ketë në dispozicion një mjek të kualifikuar, i cili të ketë njohuri në psikiatri. Do të ishte e udhës që shërbimet mjekësore të organizoheshin duke qenë në kontakt të ngushtë me administratën e përgjithshme të shërbimit shëndetësor të një rrethi ose të

³⁷ Halili, Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2010, faqe 285.

³⁸ Po aty, faqe 286.

³⁹ Po aty, faqe 286.

⁴⁰ Po aty, faqe 287.

gjithë vendit. Aty duhet të përfshihen edhe një shërbim psikiatrik për diagnostifikimin dhe, po të jetë nevoja, edhe për trajnimin e rasteve të anomalisë mendore.

2. Për të sëmurët që kanë nevojë të posaçme, duhet parashikuar transferimin në institucione penitensiare të specializuara ose në spitale civile. Kur trajtimi spitalor është i organizuar Brenda institucionit të burgut, ky duhet të jetë i pajisur me një material, me vegla dhe me prodhime farmaceutike të tilla që të bëjnë të mundur kurimin dhe trajtimin e përshtatshëm të të burgosurve të sëmurë, kurse personeli duhet të ketë një përgatitje profesionale të mjaftueshme.

3. Çdo i burgosur duhet të ketë mundësin të kurohet nga një dentist i kualifikuar.

Në institucione për gra duhet të ketë instalime të posaçme që nevojitet për trajnimin e grave shtatëzëna, lehona dhe në konvaleshencë. Sipas mundësive duhet të merren masa që lindja të kryhet në një spital civil. Në qoftë se lindja ndodh në burg është mirë që akti i lindjes të mos e përmend këtë. Kur nënave që janë në burg u lejohet të mbajnë foshnjat me vete duhet të merren masa për të organizuar një çerdhe, të pajisur me personel të kualifikuar, ku foshnjat të mund të mbahen nën kujdesin e nënës⁴¹.

Disiplina dhe dënimet

Rendi dhe disiplina duhet të mbahen me vendosshmëri, por pa bërë kufizime me shumë se sa është e nevojshme për ruajtjen e sigurisë dhe të një jete kolektive të organizuar mirë.

1. Asnjë i burgosur nuk mund të ushtrojë një pushtet disiplinor kur thirret të kryej ndonjë shërbim brenda institucionit.

2. Ky rregull megjithatë nuk duhet të bëhet pengesë për funksionin e një sistemi që bazohet në vetëqeverisje të brendshme. Ky lloj i sistemit në nfakt parashikon që disa aktivitete ose përgjegjësi të natyrës sociale, edukative dhe sportive t'u besohen, edhe nën kontroll të burgosurve të grupuar sipas mënyrës së trajtimit të tyre.

Pikat e mëposhtme duhet të jenë gjithëmonë të përcaktuara ose me ligj ose me një akt të autoritetit administrative kompetent:

- a) sjellja që përbën një shkelje disiplinore;
- b) lloji dhe kohëzgjatja e masave disiplinore që mund të zbatohen;
- c) autoriteti kompetent për vendosjen e këtyre masave⁴².

⁴¹ Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2010, faqe 287.

⁴² Po aty, faqe 288.

Mjetet shtrënguese

Mjetet shtrënguese si hekurat, zinxhirët, këmisha të forcës nuk duhet të përdoren kurrë si sanksione. Zinxhirët dhe hekurat nuk duhet po ashtu të përdoren si mjete shtrënguese. Mjete tjera shtrënguese nuk mund të përdoren veçse në rastet e më poshtme:

- a. Si masë sigurie për të shmangur arratisjen gjatë një transferimi, me kusht që ato (mjete shtrënguese) të hiqen sapo i burgosuri del përpara një organi gjyqësor ose administrativ;
- b. Për arsye mjekësore me porosi të mjekut;
- c. Me urdhër të drejtorit, në qoftë se mjetet tjera për të mbajtur nën kontroll një të burgosur nuk kanë patur sukses, me qëllim që ai të mos mundi të dëmtoj veten e tij e të tjerëve ose të shkaktojë dëme, në këtë rast drejtori duhet të konsultojë urgjentisht mjekun dhe t'i bëjë një raport autoritetit administrativ epror. Modeli dhe mënyra e përdorimit të mjeteve të shtrëngimit duhet të përcaktohen nga administrata qendrore e burgjeve. Zbatimi i tyre nuk duhet të zgjatet tej kohës krejtësisht të nevojshme⁴³.

Informimi dhe e drejta e të burgosurve për t'u ankuar

1. Çdo i burgosur kur hyn në burg duhet të ketë një informacion me shkrim mbi reagimin e të burgosurve të kategorisë së tij, mbi rregullat disiplinore të institucionit, mbi mjete që janë të lejuara për t'u informuar dhe për të formuluar ankesa, si dhe mbi çdo pikë tjetër që mund të jetë e nevojshme për t'i dhënë atij mundësinë të njohë të drejtat dhe detyrat dhe t'i përshtateten jetës së institucionit.

2. Në qoftë se i burgosuri është analfabet ky informacion duhet t'i jepet atij gojarisht.

3. I burgosuri duhet të ketë të drejtën, në çdo ditë pune, t'i parashtrijë kërkesa dhe ankesa drejtorit të institucionit ose nënpunësit që është autorizuar ta përfaqësojë.

4. Kërkesat mund t'i parashtrihen edhe inspektorit të burgjeve gjatë një inspektimi. I burgosuri mund të bisedojë me inspektorin ose me çdo nënpunës tjetër të ngarkuar me inspektimin pa praninë e drejtorit ose të anëtarëve të tjerë të personelit të institucionit.

5. I burgosuri duhet të lejohet t'i dërgojë pa censurë në përmbajtje por në një formë të përshtatshme, një kërkesë ose ankesë administratës qendrore të burgjeve, organit gjyqësor ose çdo organi tjetër kompetent, në rrugë që përcaktohet nga rregulla e burgut.

6. Me përjashtim të rasteve kur një kërkesë ose ankesë është haptazi e tepruar dhe e pathemeltë, ajo duhet të shqyrtohet pa vonesë dhe të burgosurit duhet t'i jepet një përgjigje brenda një afati të arsyeshëm⁴⁴.

⁴³ Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2010, faqe 289.

⁴⁴ Po aty, faqe 289-290.

Kontakti me botën e jashtme

Të burgosurit duhet të lejohen që nën mbikëqyrjen e nevojshme të komunikojnë me familjen e tyre si dhe me ata miq të tyre të cilëve mund t'u besohet në intervale të rregullta, si me letërkëmbim ashtu edhe duke pritur vizita.

1. Të burgosurve që janë shtetas të një shteti të huaj duhet t'u krijohen lehtësi të arsyeshme për të komunikuar me përfaqësuesit e tyre diplomatike e konsullore.

2. Për sa u përket të burgosurve shtetas të shteteve që nuk kanë përfaqësues diplomatik ose konsullor në një vend, si dhe refugjatëve dhe personave pa shtetësi, duhet t'u krijohen edhe atyre po ato lehtësi për t'u drejtuar përfaqësues diplomatik të shtetit që mbikëqyrë interesat e tyre ose çdo autoriteti tjetër kombëtar apo ndërkombëtar që ka për detyrë t'i mbrojtë⁴⁵.

Bibloteka

Çdo burg duhet të ketë një bibliotekë të hapur për të gjitha kategoritë e të burgosurve dhe mjaft të pasur me libra instruktiv dhe çlodhës. Të gjithë të burgosurit duhet të nxiren ta përdorin bibliotekën sa më shumë⁴⁶.

Inspektimi

Inpektorët e kualifikuar dhe me provojë, të caktuar nga një organ kompetent, duhet të kryejnë inspektime të rregullta në burgjet dhe shërbimet në to. Ata duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë që këto institucione të administrohen në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe me qëllim që të arrihen objektivat e shërbimeve penitensiare dhe korrektuese⁴⁷.

⁴⁵ Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2010, faqe 290.

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Po aty, faqe 293.

KREU I I DYTË

NOCIONI, LLOJET E VRASJEVE, VEPRIMI I KRYERJES, PASOJAT

1. VEPRA PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT

Vepra penale kundër jetës janë vepra më të rënda sepse ato çenojnë të drejtën për të jetuar si një e drejtë më e çmuar dhe themelore, e cila njëkohësisht është e garantuar edhe me kushtetutë edhe me aktet ndërkombëtare.

a) Respektimi ndaj jetës së njeriut dhe integritetit trupor paraqet bazën elementare të civilizimit tonë. Historia e njerzimit është edhe histori e luftës së njeriut për ekzistencën e tij fizike kundër vetëvrasjes (për dallim nga bota shtazore, në të cilën armik i njerit është lloji tjetër, ndërkaq, armiku më i madh i njeriut, është siç thuhet, vetë njeriu!).⁴⁸

b) Jeta e njeriut – mbrojtja e jetës së njeriut ka karakter absolut, në kuptimin që jeta mbrohet pa marrë parasysh ndjenjën për jetë, interesin jetësor të individit, pa marrë parasysh vlerësimin e jetës së individit nga ana e shoqërisë, dhe pa marrë parasysh atë se për cilën fazë të jetës bëhet fjalë. Megjithatë, ekzistojnë edhe disa përjashtime nga kërkesa për respektin absolut të jetës së njeriut, siç janë: lufta, dënimi me vdekje në disa legjislacione, vrasja në mbrojtje ekstreme, andaj, del se respekti ndaj jetës biologjike të njeriut ka të bëjë me orientimet themelore sociologjike dhe antropologjike të shoqërisë, me çka mund të kosiderohet se e drejta themelore e njeriut në jetë duron edhe disa kufizime të caktuara sociale⁴⁹.

Vepra penale kundër jetës dhe trupit shprehet si një raport i caktuar interpersonal midis kryerësit dhe viktimës, që më së shpeshti e merr trajtën e kontaktit të drejtëpërdrejtë fizik. Në një numër të madh të rasteve në ngjarjen kriminale kontribut ka edhe vetë objekti i sulmit, pra, viktima. Presupozimi se te një numër i madh të veprave ekziston ndonjë kontribut i viktimës dhe se nga studimi i rolit të saj në kryerjen e veprës mund të rezultojnë njohuri të shumta me vlera teorike dhe praktike, ka sjellë deri te paraqitja e një disipline të veçantë në kuadër të kriminologjisë, pra, paraqitja e viktimologjisë, si shkencë mbi viktimën⁵⁰.

Njeriu ka liri absolute të disponimit me jetën e vetë dhe integritetin trupor: vetëvrasja nuk është vepër penale; gjithashtu vetëlëndimi, përveçse kur paraqet mënyrë të rrezikimit të të mirave

⁴⁸ Zejneli.Ismail,E drejta penale pjesa e posaçme,Tetovë,2007,faqe 17.

⁴⁹ Po aty,faqe 18.

⁵⁰ Po aty.

tjera shoqërore (kështu te vepra e nenit 342 të KP-së). Liria e njeriut që të disponojë me këto të mira nuk përfshin edhe lirinë e tij që tjetri t'ia bartë autorizimin për të disponuar me to. Së këndejmi, nuk është përjashtuar kundërligjshmëria e vrasjes e kryer në bazë të kërkesës së viktimës, ose me shprehjen paraprake të pajtimit të viktimës. E njëjta vlen edhe për lëndimet trupore⁵¹.

Sipas objektit të mbrojtjes dhe formës së sulmit, disa vepra nga ky kapitull mund t'i ndajmë në disa nëngrupe, edhe atë⁵²:

- Vepra penale kundër jetës: neni 123-128;
- Vepra penale kundër jetës së ardhshme (fryti-foshnjës): neni 129;
- Vepra e rrezikimit: neni 132 dhe neni 133;
- Vepra penale të braktisjes (mosdhënia e ndihmës; braktisja e personave të pa aftë); nenet 134-136.

1.1 NOCIONI I VRASJES

Me vrasje nënkuptojmë atë vepër të kundërligjshme, me anë të së cilës i meret jeta një personi tjetër me dashje ose nga pakujdesia. Përveç veprës themelore të vrasjes ekzistojnë edhe vepra të kualifikuara dhe të privileguara të vrasjes, të cilat nga vepra themelore dallohen me disa rrethana shtesë, siç janë: mënyra e kryerjes, karakteristikat e viktimës, rrethanat subjektive dhe të ngjajshme.

Objekt i mbrojtjes të të gjitha veprat e vrasjes është jeta e njeriut.

Veprimi i kryerjes është përcaktuar nëpërmjet shkaktimit të pasojës: privimit nga jeta, dhe çdo veprim me të cilin shkaktohet vdekja e një personi. Pasoja qëndron në paraqitjen e vdekjes. Vepra konsiderohet se është përfunduar në momentin e paraqitjes së vdekjes.

Subjekti i veprës penale të vrasjes mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën e caktuar me ligj për përgjegjësi penale.

Vrasja mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia.

Për veprën penale të vrasjes është paraparë dënimi me burgim në kohëzgjatje prej më së paku pesë vitesh neni 123, paragrafi 1⁵³.

⁵¹ Zejneli.Ismail,E drejta penale pjesa e posaçme,Tetovë,2007,faqe 19.

⁵² Po aty,faqe 19.

⁵³ Po aty,faqe 19.

Forma e rëndë e veprës penale të vrasjes është paraparë në Paragrafin 2, dhe konsistohet se është kryer në këto raste: nëse tjetri privohet nga jeta në mënyrë të paskrupullt; nëse tjetri privohet nga jeta me paramendim; nëse tjetri privohet nga jeta për arsye të ndonjë interesi ose për fshehje të ndonjë veprë tjetër penale; nëse tjetri privohet nga jeta me porosi; nëse privohet nga jeta gruaja shtatëzën apo nëse privohet nga jeta personi zyrtar ose ushtarak gjatë kryerjes së detyrave të sigurimit publik në ruajtjen e rendit publik. Për këtë formë të veprës penale është paraparë dënimi me burgim në kohëzgjatje prej më së paku dhjetë vitesh ose dënim me burgim të përjetshëm⁵⁴.

2. DISA LLOJE TË VRASJES SË RËND

Vrasja e kualifikuar (e rëndë) është privim i paramenduar i tjetrit nga jeta, i kryer në rrethana specifike rënduese, të përcaktuara me ligj, që e ngrenë shkallën e të padrejtës dhe të fajsisë të kryerësit, për të cilat ligji për këtë veprë parasheh dënim të rëndë (burgim të përjetshëm). Vrasja e kualifikuar dallohet nga vrasja e rëndomtë sipas rrethanave të caktuara kualifikuese të natyrës objektive ose subjektive⁵⁵.

Së këndejmi, mund të dallojmë më tepër grupe të rrethanave që vrasjes me paramendim i japin karakteristikën e ndonjëris nga vrasjet e rënda të përfshira në këtë dispozitë (përndryshe, karakterin e vrasjeve të kualifikuara e kanë edhe veprat tjera jashët këtij kapitulli, si p.sh.: ato të parapara në nenet 237, 238 dhe 309 të KP-së të RM-së⁵⁶);

Rrethanat që kanë të bëjnë me mënyrën e kryerjes: vrasja në mënyrë mizore vrasja me vënie në rrezik të jetës edhe të ndonjë personi tjetër.

Rrethanat subjektive që kanë të bëjnë me motivet e kryerësit: vrasja nga lakmia (fitimi pasuror) për shkak të kryerjes ose fshehjes së veprës tjetër penale, vrasja nga hakmarrja (e vrazhdë), nga motive tjera të ulta: si, vrasja në bazë të porosisë.

Rrethanat që kanë të bëjnë në karakteristikën dhe dëtyrimin e viktimës: vrasja e personit zyrtar ose ushtarak në kryerjen e detyrimeve të caktuara të sigurisë ose gjykatësit, prokurorit publik ose avokatit gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

Ekzistimi i më shumë rrethanave kualifikuese është me rëndësi për matjen e dënimit.

⁵⁴ Zejneli.Ismail,E drejta penale pjesa e posaçme,Tetovë,2007,faqe 20.

⁵⁵ Po aty,faqe 20.

⁵⁶ Po aty,faqe 20-21.

Për vrasjet e kualifikuara është paraparë dënimi me burgim të kohëzgjatjes prej së paku dhjetë vitesh ose dënimi me burgim të përjetëshëm. Ky dënim zbatohet edhe për vrasjet e paramenduar të dy ose më shumë personave, për të cilat kryerësit paraprakisht nuk janë dënuar, përveç nëse nuk bëhet fjalë për vepra të kryera me tejkalimin e nevojës ekstreme ose për vrasje të privilegjuara (neni 123 paragrafi 3 i KP të RM-së⁵⁷).

2.1 Vrasja në mënyrë mizore

Çdo privim nga jeta është thjesht i ndërlidhur me vuajtje më të mëdha fizike dhe psiqike të viktimës. Vrasja në mënyrë mizore karakterizohet me shkallën enorme të mundimeve dhe vuajtjeve fizike të viktimës. Për ekzekutimin e këtij lloji të vrasjes janë të nevojshme dy elemente të natyrës objektive dhe subjektive. Elementi objektiv shprehet në të shkaktuarit e mundimeve dhe dhimbjeve të mëdha ndaj viktimës, ndërkaq, elementi subjektiv në vetëdijen dhe dëshirën, përkatësisht pëlqimin e kryerësit që të shkaktohen mundimet dhe dhimbjet e tilla⁵⁸.

2.2 Vrasja në mënyrë tinzare (dinake)

Kjo vrasje e kualifikuar karakterisohet me intensitetin e saj më të lartë. Ajo paraqet veprimin që në kuptimin objektiv dhe subjektiv i tejkalojn suzat e fshehtësisë dhe dinakërisë të cilat rëndom shfaqen te vrasja me dashje.

Nga ana objektive, te ky lloj i vrasjes, kryerësi vepron në mënyrë të fshehtë, ndërsa në aspektin subjektiv kryerësi vepron në mënyrë tinzare (dinake), jo të sinqertë, mashtruese dhe me qëllim të keq si dhe duke shfrytëzuar edhe besimin e viktimës që ka ndaj tij.

Vrasja në mënyrë tinzare mund të kryhet vetëm me dashje direkte⁵⁹.

2.3 Vrasja me dashje me ç'rast rrezikohet jeta e personave tjerë

Vrasja e tillë ekziston atëherë kur bëhet fjalë për atë në mënyrë të kryerjes, me të cilën kryerësi shkon, vepron, ose pajtohet me atë që ta vejë në rrezik jetën edhe të ndonjë personi tjetër gjatë kryerjes së veprës penale të vrasjes. Për kryerjen e vrasjes kryerësi ndërmerr veprim

⁵⁷ Zejneli.Ismail,E drejta penale pjesa e posaçme,Tetovë,2007,faqe 21.

⁵⁸ Po aty,faqe 21.

⁵⁹ Po aty,faqe 21-22.

përgjithësisht të rrezikshëm (përdorimi i armës së zjarrit, hedhja e bombës në grupin e njerëzve dhe ngjajshëm), me ç'rast rrezikimi i ndonjë personi tjetër është nus-produkt i kryerjes së veprës.

Për ekzistimin e kësaj vrasje të kualifikuar është e nevojshme të shkaktohet rreziku konkret për jetën së paku edhe të një personi tjetër, përveç viktimës së vrasjes. Ana subjektive të vepra kryhet me dashje e cila duhet të përmbajë edhe vetëdijen për rrezikimin e jetës edhe të personave tjerë. Vrasja e kualifikuar do të ekzistojë, kur gjatë kryerjes së vrasjes me dashje është privuar nga jeta edhe ndonjë person tjetër. Ky lloj i vrasjes mund të kryhet me dashje-direkte apo me dashje eventuale⁶⁰.

2.4 Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore

Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore ekziston në raste kur privimi nga jeta e personit tjetër kryhet me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjell ndonjë dobi pasurore. Vrasja është mjet që të arrihet deri te dobia materiale për vete ose për tjetrin, që shprehet si zmadhim (kështu, p.sh.: që të arrihet deri te pasuria e viktimës, deri te shpërblimi i premtuar} ose që t'i shmanget zvogëlimit të pasurisë së kryerësit (kështu p.sh.: që të mund të lirohet nga borxhi i vetë ndaj viktimës).

Vepra ekziston edhe kur kryerësi vetëm presupozon, beson se do ta arrijë dobinë e tillë. Gjithashtu, nuk është e domosdoshme të realizohet fitimi kah i cili ka synuar kryerësi⁶¹.

2.5 Vrasja e personit me qëllim të fshehtësisë së veprës penale

Vrasja e tillë ekziston atëherë kur privimi nga jeta e personit tjetër është mjet për realizimin e ndonjë qëllimi tjetër, kryerjes së ndonjë vepre penale apo edhe fshehjen e veprës penale të kryer më herët.

Ajo është karakteristike për të dy situatat. Në të parën (vrasja për shkak të kryerjes tjetër penale}, privimi nga jeta është fazë paraprake, veprimi përgaditor për kryerjen e cilës do qoftë vepre penale (kështu, p.sh.: kur dikush e vret rojtarin që më vonë të hyjë në ndërtesë, ose e vretë burrin që më vonë ta përdhunojë gruan e tij). Vrasja e kualifikuar ekziston pa marrë parasysh se vepra tjetër a është kryer në të vërtetë.

⁶⁰ Zejneli.Ismail,E drejta penale pjesa e posaçme,Tetovë,2007,faqe 22.

⁶¹ Po aty,faqe 22-23.

Situata e dytë, ekziston në raste kur kryerësi e privon nga jeta personin tjetër, me qëllim që të pengojë zbulimin e veprës penale e cila është kryer më parë⁶².

2.6 Vrasja nga hakmarrja e paskrupullt

Nocioni i përgjithshëm i vrasjes nga hakmarrja e paskrupullt asocon në gjakmarrjen. KP-ja nocionin e paskrupullsisë e ndërlihd vetëm me hakmarrjen. Hakmarrja e paskrupullt ka disa elemente të përbashkëta me hakmarrjen dhe gjakmarrjen, por, ka edhe disa dallime të rëndësishme të cilat i përkasin vetë personalitetit të kryerësit të vrasjes nga hakmarrja, siç janë më shpesh: arsyeja që është shkak i kësaj forme të hakmarrjes, personi ndaj të cilit është drejtuar kjo vrasje dhe një varg rrethanash tjera, të cilat mund të gjejnë shprehje me rastin e kryerjes së veprës në fjalë. Në lidhje me personalitetin e kryerësit, sipas mendimit të disa autorëve, nocioni i paskrupullsisë të kjo vrasje, në radhë të parë është i lidhur me sjelljet negative të njerëzve.

Është i pranuar qëndrimi se çdo vrasje nga hakmarrja nuk mund të konsiderohet si vrasje nga hakmarrja e paskrupullt. Një vrasje nga hakmarrja e paskrupullt mund të konsiderohet si i tillë nëse është e drejtuar ndaj ndonjë personi të pa fajshëm apo nëse qëllimi i hakmarrjes nuk është në përpjestim me të keqen e shkaktuar më parë⁶³.

2.7 Vrasja nga motivet e ulëta

Motivet e ulëta nuk është përcaktuar në ligj, por mund të nxirret nga konteksti i tërë dispozitës dhe nga ajo që i karakterizon motivet e ulëta të sipër përmendura.

Edhe praktika jonë gjyqësore niset nga qëndrimet dhe pikëpamjet etike, morale dhe sociale siç janë, p.sh.: xhelozia, e cila nuk është motiv, por, gjendje specifike shpirtërore e një personi, nga ajo gjendje mund të dalin motive të ulëta, që duhet në mënyrë të veçantë të verifikohen⁶⁴.

⁶² Zejneli.Ismail,E drejta penale pjesa e posaçme,Tetovë,2007,faqe 23.

⁶³ Po aty,faqe 23-24.

⁶⁴ Po aty,faqe 23.

2.8 Vrasja në bazë të porosisë

Për dallim nga vrasja nga lakmia (fitimi), kjo vrasje e kualifikuar mund të kryhet edhe nga motive tjera, që nuk domethënë se synimi i saj çdoherë të jetë arritja e dobisë (fitimit) pasuror. Bëhet fjalë, për vrasje të organizuar, në realizimin e së cilës marrin pjesë së paku dy persona: personi që porosinë (porositësi) dhe kryerësi i drejtpërdrejtë.

Përveç vrasjes së paguar, pas kësaj vrasje të kualifikuar mund të qëndrojnë edhe motive dhe lidhje tjera të kryerësit dhe porositësit, siç mund të jenë, lidhjet politike, ekonomike, etj. Porositësi përgjigjet si nxitës i vrasjes së rëndë⁶⁵.

2.9 Vrasja e gruas shtatzënë

Vrasja fiton llojin e kualifikuar për shkak të kumulimit të dy të pa drejtave, të krijuara me marrjen e dy jetërave: jetës aktuale (të gruas shtatzënë) dhe jetës së ardhshme (foshnjës). Pra, në fakt, fjala është për të ashtuquajturën “vrasje të dyfishtë”, ngase me këtë veprë penale nuk vritet vetëm gruaja shtatzënë, por edhe fëmija i saj i cili ende nuk ka lindur.

Paramendimi i kryerësit duhet të përmbajë vetëdijen për karakteristikën e viktimës, për atë se bëhet fjalë për gruan shtatzënë.

Ky lloj i vrasjes do të konsiderohet se ekziston vetëm nëse kryerësi ka ditur se objekti i kësaj veprë penale është gruaja shtatzënë. Nëse dorasi nuk e ka ditur se gruaja të cilën e privon nga jeta është shtatzënë, atëherë kryerësi i kësaj veprë do të përgjigjet për vrasje të rëndomtë, apo ndonjë tjetër të vrasjes së rëndë, varësisht nga motivet, rrethanat apo mënyrat e kryerjes, e jo për kryerjen e vrasjes së kualifikuar. Te kjo veprë penale nuk ka rëndësi faza e shtatzënisë⁶⁶.

3. Vrasje nga motive fisnike

3.1 Eutanazia

Me konceptet filozofike, etike, medicinale dhe juridike për vdekjen është ndërlidhur ngushtë edhe çështja e eutanazisë. Dhënia e ndihmës në vdekje, “vdekja e butë”, përkatësisht “vdekja e butë dhe e lehtë” ka të bëjë me situatat e ndryshme: vrasja e personit të sëmurë të pa shërueshëm që nuk

⁶⁵ Zejneli.Ismail,E drejta penale pjesa e posaçme,Tetovë,2007,faqe 24.

⁶⁶ Po aty,faqe 25.

ka shpëtim dhe është duke vdekur që t'i zvogëlohen dhimbjet gjatë vdekjes; vdekja nga mëshira e personit që është i sëmurë dhe i pa shpresë për t'u shëruar edhe pse nuk vdes që t'i shkurtohen mundimet dhe të çohet deri te vdekja e shpejtë dhe pa dhimbje; shkurtimi nga mëshira e një jete të pa vlefshme, siç është, vrasja e personit të pa aftë për jetë⁶⁷.

Për të drejtën penale problemi i eutanazisë shtrohet si një problem i legalizimit ose trajtimit më të butë të vrasjes nga mëshira, përkatësisht vrasja në bazë të kërkesës së vetë viktimës. Qasja juridike-penale ndaj kësaj problematike është determinuar nga shkaqet dhe faktorët e ndryshëm kulturologjik, civilizues dhe historik, si dhe me ndikimin e pikëpamjeve dominante filozofike dhe etike.

Në disa legjislacione, (si, për shembull, në legjislacionet e disa shteteve amerikane) është legalizuar e ashtuquajtura “eutanzia pasive”, e cila konsideron në ndërprerjen e mbajtjes së mëtejshme artificiale në jetë të pacientit për të cilin është konstatuar (nga konziliumi i mjekëve) se është një rast i pa shpresë. Lëvizjet për legalizimin e eutanazisë në legjislacionet evropiane fillojnë me miratimin e Ligjit holandez (në vitin 2001) për kontrollin e vrasjeve në bazë të kërkesës së viktimës dhe dhënia e ndihmës gjatë vetëvrasjes. Ligji përcakton gjashtë kritere sipas të cilëve mjeku mund ta ndërpresë dhënien e ndihmës tjetër dhe t'i ndihmojë në vdekje (me dhënien e injeksioneve speciale) pacientit gjatë shprehjes së kërkesës së tij të lirë dhe të vetëdijshme si dhe caktimi dhe verifikimi kolegjial se bëhet fjalë për një rast të pa shpresë. Vendimi i tillë i nënshtrohet kontrollit plotësues nga ana komisionit të posaçëm të mjekëve⁶⁸.

4. Vrasje nga pakujdesia

Vrasja nga pakujdesia konsiderohet se është kryer nëse dikush privohet nga jeta për shkak të pakujdesisë së kryerësit të veprës penale.

Vrasja nga pakujdesia paraqet një rrezikshmëri shoqërore më të vogël në krahasim me vrasjet e kryera me dashje. Konsiderohet si formë më e lehtë e vrasjes vetëm për shkak të formës së fajit me të cilën kryhet.

Te vrasja nga pakujdesia privimi i ndonjë personi nga jeta manifestohet në mënyrë specifike. Zakonisht këtu bëhet fjalë për veprime të cilat janë ndërmarrë për qëllim tjetër e jo për qëllim të

⁶⁷ Zejneli.Ismail,E drejta penale pjesa e posaçme,Tetovë,2007,faqe 25.

⁶⁸ Po aty,faqe 26.

privimit të ndonjë personi nga jeta. Te vrasja nga pakujdesia, shkaktimi i pasojës nuk është i dëshiruar.

Subjekti i kryerjes së kësaj vepre penale mund të jetë cilido person që ka arritur moshën e duhur dhe që është i përgjegjshëm. Lidhur me anën subjektive (pakujdesia) është irelevante se a bëhet fjalë për pakujdesi të vetëdishme apo të pavetëdishme⁶⁹.

5. Vrasja e foshnjës gjatë lindjes (fëmijëvrasje)

(Neni 127 i KP të RM-së)

Vrasja e foshnjës gjatë lindjes paraqet një lloj të posaçëm të vrasjes së privilegjuar dhe dallohet nga veprat tjera për nga gjendja psikike e posaçme e kryerësit.

Veprën penale e kryen e ëma gjatë lindjes ose menjëherë pas lindjes në një gjendje të shqetësuar të shkaktuar gjatë lindjes.

Kjo vepër mund të kryhet vetëm me dashje dhe së këndejmi nuk ekziston kjo vepër penale në raste kur e ëma nga pakujdesia e privon nga jeta foshnjën e saj gjatë lindjes ose menjëherë pas lindjes.

Subjekti i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm e ëma e cila e privon nga jeta foshnjën e saj. Rëndësi të madhe këtu ka studimi i motiveve të cilat janë të ndryshme, si shtatzënia jashtë-martesore apo të ngajshme. Viktima e kësaj vepre penale mund të jetë vetëm foshnja që ka lindur e gjallë, pa marë parasysh se a ka qenë e aftë për të jetuar.

Për këtë vepër penale të privilegjuar është paraparë dënimi me burgim prej tre muaj deri në tre vjet, gjithashtu në mënyrë të posaçme është i rëndësishëm edhe tentimi për ta përfunduar veprën⁷⁰.

6. OBJEKTI I MBROJTJES DHE OBJEKTI I VEPRIMIT

Çdo vepër penale ka objektin e vet të mbrojtjes, ashtu që është e pakuptimtë të ekzistojë vepër pa objekt të mbrojtjes. Objekti i mbrojtjes është nocion abstrakt, gjenerik, i cili e përfshin idenë e të mirës juridike, vlerës apo interes që mbrohet me inkriminimin konkret. P.sh. objekti i mbrojtjes në veprën vrasje është jeta e njeriut si vlerë më e lartë e tij, në vjedhjen, e drejta e pronës

⁶⁹ Zejneli.Ismail,E drejta penale pjesa e posaçme,Tetovë,2007,faqe 27.

⁷⁰ Po aty,faqe 27-28.

si e drejtë pronësore etj. Objekti i mbrojtjes nuk mund të identifikohet me pasojnën e veprës, e cila çdoherë shprehet si pasojë në botën e jashtme⁷¹.

Objekti i mbrojtjes si nocion abstract juridik është i pashkatërrueshëm! Ai ekziston derisa me ndryshime të ligjit nuk hiqet nga sistemi i vlerave të së drejtës penale. Vepra penale mund të ketë më tepër objekte të mbrojtjes. P.sh. plaçkitja (n.237 KPM) si vepër e komplikuar e përbërë nga detyrimi dhe vjedhja, për objekte të mbrojtjes ka lirinë e personit dhe të drejtën e pronës! Ekzistimi i më shumë objekteve mund të ndikojë në strukturën e veprës penale, e cila bëhet e përbërë për ta shprehur mbrojtjen e çdokujt nga ajo. Ashtu p.sh. në veprën e përdhunimit (n.116), liria e gjinisë si objekt i mbrojtjes konsumon në vete nderin dhe autoritetin, dhe në ,masë të caktuar integritetin trupor të viktimës! Gjithashtu më shumë vepra penale mund të kenë vetëm një objekt të njëjtë të mbrojtjes: p.sh format e ndryshme të vrasjes, të lëndimeve trupore, veprat kundër nderit dhe autoritetit etj⁷².

Për dallim nga objekti i mbrojtjes, objekti i veprimit është pjesë nga bota e jashtme, shkelja apo kërcënimi i së cilit paraqitet si pasojë e veprës penale. Ashtu p.sh. objekti i veprimit të vrasja është trupi i viktimës, të vjedhja është sendi i lëvizshëm që merret etj.

Me objekt të veprimit nënkuptojmë personin apo vlerën tjetër juridike ndaj të cilit është ndërmarrë veprimi i kryerjes, me ç'rast dëmtohet apo rezikohet objekti që mbrohet nga e drejta penale. Çdo vepër penale ka objekt të mbrojtjes, por jo edhe çdo vepër ka objekt të veprimit! Ashtu është rasti me veprat "formale", e padrejta e të cilëve zbrazet me marrjen e veprimit të caktuar, pa figurën e tyre ligjore të përfshijë edhe paraqitjen edhe të ndonjë pasoje (ashtu p.sh., mosparaqitja e veprës penale apo kryerësit, n.364 KPM)⁷³.

6.1 Rëndësia e objektit të mbrojtjes

Objekt i përgjithshëm i mbrojtjes janë liritë dhe të drejtat individuale dhe funksionet e përbashkëta të jetës me të cilat mundësohet realizimi dhe avancimi i tyre. Objekt grupor i mbrojtjes është ndonjë e mirë juridike, siç janë jeta dhe trupi, prona etj., në të cilën janë të sublimuar objektet special të mbrojtjes së veprave konkrete penale: vrasja si objekt sulmi ka jetën, lëndimi trupor ka integritetin trupor etj. Dallimi në objekt grupor dhe special është bazë për sistematikën e veprave penale në pjesën e posaçme, e cila është me rëndësi legjislative-teknike apo jurisiko-estetike. Të gjitha veprat penale të përfshirë në KPM janë të sistematizuar në kapituj të veçantë sipas objektit

⁷¹ Kambovski.Vllado,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup,2010,faqe 129.

⁷² Po aty.

⁷³ Po aty.

grupor të mbrojtjes, ndërsa struktura e brendshme të çdo kapitulli është i determinuar me raportin në mes objekteve speciale dhe formave të ndryshme apo shkallës së sulmit ndaj objektit grupor⁷⁴.

7. VEPRIMI I KRYERJES

Me veprim të kryerjes nënkuptojm veprimin me të cilin realizohet figura ligjore e veprës penale. Çdo vepër penale ka veprimin e vet të kryerjes, kurse ajo paraqet konkretizim të nocionit të përgjithshëm të veprimit. Veprimi i kryerjes është i domosdoshëm për përshkrimin ligjor të çdo vepre penale. Ligdhënësi shfrytëzon teknikë të ndryshme në përshkrimin e tij, duke filluar nga natyra e së mirës së mbrojtur dhe intensiteti i mbrojtjes së saj. Ashtu së pari veprimi mund të përshkruhet direkt si kryerje e caktuar apo lëshim, apo indirekt, nëpërmjet përshkrimit të pasojës që mund të shkaktohet me çfarëdo veprimi⁷⁵.

Përshkrimi ligjor i veprës mund të përfshijë një veprim të kryerjes dhe atëherë bëjmë fjalë për unitet të veprimit, por gjithashtu mund të parasheh dy veprime kumulative (përdhunimi, n.186: detyrimi për dhunim), apo veprime me më shumë alternative (në keqpërdorimin e të dhënave personale, n.149; ai që në mënyrë joligjore pa pajtimin e qytetarit mbledh, përpunon ose shfrytëzon të dhënat e tij personale)⁷⁶.

Shumica e inkriminimeve janë paraparë në lloj të përshkrimeve ligjore të veprimit të kryerjes, por të disa nga ato veprimi është përcaktuar *exempli causa*, në çka është lënë mundësia që me shfrytëzimin e klauzolës gjenerale nën veprimin e kryerjes të vihen edhe veprime tjera, të ngjajshme me ato të paraparët (ashtu të bartja e sëmundjeve ngjitëse, n.205: me kryerje të veprimit seksual, apo në mënyrën tjetër shkakton bartjen e sëmundjes ngjitëse). Me klauzolën gjenerale kuptohet çdo veprim që është i ngjajshëm me atë të paraprin (analogjia *intra legem*)! Për dallim nga përshkrimet e këtilla të disa vepra ligji më së afërmi e përshkruan jo vetëm veprimin, por edhe elementet tjera të tij që edhe më tej e konkretizojnë sipas mënyrës, mjetit, vendit apo kohës së kryerjes (ashtu në raport me mënyrën – n.123 p.2: privimi nga jeta tjetrit në mënyrë mizore; mjetin- n.133: rrezikim me mjet gjatë rrahjes apo përleshjes; vendi – n.227 p.2: shkaktim zjarri në pyllin e mbrojtur; koha – n.236 p.1: vjedhje në kohë të zjarrit apo ndonjë fatkeqësie tjetër)⁷⁷.

⁷⁴ Kambovski.Vllado,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup,2010,faqe 130.

⁷⁵ Po aty,faqe 153.

⁷⁶ Po aty,faqe 153.

⁷⁷ Kambovski.Vllado,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup,2010,faqe 154.

8. PASOJA

Studimi për objektin mbrojtës penalo-juridik është bazë mbi të cilin më tej zhvillohet studimi për pasojën e veprës penale. Çdo vepër penale ka pasojë, e cila përbëhet nga shkallë të ndryshme të rrezikimit, apo shkeljes të së mirës së mbrojtur juridike. Në pasojë të till vlerësuese mendon edhe ligjdhënësi, kur në pjesën e përgjithshme të KPM i përdor nocionet “Pasoje e dëmshme” (n.13 dhe 14) shkalla e rrezikimit ose shkelja e së mirës juridike (n.39 p.2).⁷⁸

Neni 13: Vepra penale është kryer me dashje kur kryerësi ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e ka dashur kryerjen e saj ose kur ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të veprimit apo mosveprimit të tij mund të shkaktohet pasojë e dëmshme, por është pajtuar me shkaktimin e saj⁷⁹.

Neni 14: Vepra penale është kryer nga pakujdesia kur kryerësi ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të veprimit ose mosveprimit të saj mund të shkaktohet pasojë e dëmshme, por me mendjelehtësi ka menduar se do ta pengojë ose ajo nuk do të shkaktohet ose kur nuk ka qenë i vetëdijshëm për mundësinë e shkaktimin të pasojave të dëmshme, edhe pse sipas rrethanave dhe sipas vetive të veta personale ka qenë i detyruar dhe ka mundur të jetë i vetëdijshëm për atë mundësi⁸⁰.

Neni 39, paragrafi 2: Gjykata do t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë, dënimi të jetë më i madh apo më i vogël (rrethanat lehtësuese dhe vështroese), veçanarisht shkallën e përgjegjësisë penale, motivet pse është bërë vepra penale, fuqinë e rrezikimit apo shkatërrimit të së mirës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është bërë vepra, kontributin e viktimës në kryerjen e veprës, jetën e mëhershme të kryerësit, kushtet e tij personale dhe sjelljen e tij pas veprës së bërë penale, si dhe rrethanat e tjera që i përkasin personalitetit të kryerësit⁸¹.

Jo çdo figurë ligjore patjetër të mbajë edhe objekt të veprimit, e me të edhe veprimi në pasojë konkrete në formë të një gjëje të kapshme, ndryshim real i objektit të veprës. Ekzistojnë edhe vepra, padrejtësia e të ndaluara, apo në lëshimin e veprës së imponuar. Të tilla janë, p.sh.: fyerja (n.173 KPM), mosparaqitja e veprës penale ose të kryerësit (n.136) etj⁸².

⁷⁸ Kambovski.Vllado,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup,2010,faqe 156.

⁷⁹ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë,neni 13.

⁸⁰ Po aty,neni 14.

⁸¹ Po aty,neni 39,p.2.

⁸² Kambovski.Vllado,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup,2010,faqe 157

KREU I TRETË

ASPEKTET KRIMINOLOGJIKE TË DËNIMIT ME BURG

1. FENOMENOLOGJIA E SHQIPTIMIT TË DËNIMIT ME BURG NË RRETHIN E GJYKATËS THEMELORE TË TETOVËS GJATË VITEVE 2012 DERI VITIT 2018.

Një ndër format më të rënda të dënimit për parandalimin e kriminalitetit që i shqiptojnë gjykatat është dënimi me burg apo heqje të lirisë, nga ky shkak dhe për këtë arsye, kemi zgjedhur këtë problem nga se prania e kriminalitetit është shumë e theksuar dhe sfidë e kohës bashkëkohore, në theks të veçantë në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës.


Tabela numër 1.⁸³

Numri i personave të dënuar për vepër penale “Vrasje”

VITI I KRYERJES	NUMRI I VEPRËS PENALE PËR VRASJE TË DËNUAR ME BURGIM	GJITHËSEJ
2012	22	
2013	31	
2014	44	
2015	62	
2016	14	
2017	15	
2018	33	
		221

⁸³ Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Tetovës.

PËRQINDJA E TË DËNUARVE ME BURG NDËR VITE



Në tabelën numër 1 kemi paraqitur numrin e personave të dënuar me burg në vitet e caktuara me çka shihet qartë numri i të dënuarve brenda një viti në procedurë gjyqësore me vendim dhe numri i përgjithshëm që është 221. Nga evidencat që mbahen në arkivin e Gjykatës Themelore të Tetovës për dënim me burgim për veprë penale “vrasje” për vitet 2012 e deri vitin 2018 ku nëse shikojmë vitet veç e veç del se në vitin 2012 kemi 22 vendime gjyqësore me dënim me burgim, në vitin 2013 kemi 30 raste të dënimit me burg, në vitin 2014 kemi 44 raste, në vitin 2015 kemi 62 raste të dënimit me burg të shqiptuar nga gjykata e Tetovës, në vitin 2016 kemi 14 raste, në vitin 2017 kemi 15 raste dhe në vitin 2018 kemi 33 raste gjithësej.⁸⁴ Nëse bëjmë një karahasim të dënimit me burg për periudhën e caktuar në bazë të të dhënave do të vërejmë se kemi rritje të madhe të kësaj dukurie ndër vite apo nga viti në vit me çka më pak janë në vitin 2016 dhe atë 14 raste, kurse në vitin 2015 kemi 62 raste të dënimit me burg për veprë penale për “vrasje”, që kuptohet se shoqëria jonë ndër vite prokuponet gjithnjë e më shumë dhe kriminaliteti është në rritje ku shihet nga shifrat. Lidhur me ecurinë e dënimit me burgim në Gjykatën Themelore të Tetovës gjatë vitetve 2012-2018 rezulton se prej vitit 2012-2018 kemi 19% përqindje rritje të dënimit me burgim. Gjithashtu kemi edhe numrin e përgjithshëm apo totalin e dënimit me burg nga këto të dhëna prej viti 2012 deri 2018 që rezulton se është 221.

⁸⁴ Të dhënat e bazuara nga evidencia në arkivin e Gjykatës Themelore të Tetovës për vitet 2012-2018.

1. STRUKTURA E PERSONAVE TË DËNUAR

Sipas të dhënave që nxorëm gjatë hulumtimit në arkivin e Gjykatës Themelore të Tetovës për veprë penale kundër jetës dhe trupit, me dënim me burgim gjatë viteve 2012 deri vitin 2018, në vazhdim do të paraqesim një tabelë në të cilën do të paraqesim të dhënat e shfrytëzuara.

Lloj i veprës penale dhe numri i dënimit me burgim

Tabela numër 2.⁸⁵

Numëri i lëndës	Lloj shkresë	Bazë shkresë juridike	Vendim	Shkresë – Vendim
K-287/12	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-287/12	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-182/12	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-182/12	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-182/12	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-239/12	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-239/12	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-239/12	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-303/13	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-303/13	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-789/13	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-789/13	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-1/13	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-1/13	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-1/13	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-443/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-443/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-872/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-872/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-656/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-656/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-543/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-543/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-847/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-847/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-523/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-523/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-597/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-597/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-117/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-117/14	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit

⁸⁵ Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Tetovës.

K-321/17	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-206/17	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-206/17	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-155/17	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-155/17	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-198/17	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-198/17	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-163/17	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-288/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-288/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-331/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-331/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-488/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-488/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-80/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-80/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-600/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-600/18	Atakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-120/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-120/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-120/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-489/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-489/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-489/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-561/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-561/18	Aktakuzë	Vrasje	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit

1.1.1 MOSHA E PERSONAVE TË DËNUAR

Si karakteristik e rëndësishme e personalitetit dhe fenomenit kriminal është edhe mosha. Të dhënat e shumta statistikore nga praktika gjyqësore si dhe shënimet empirike kriminologjike, flasin se me veprime dhe sjellje kriminale merren persona të moshave të ndryshme. Mirëpo edhe në këtë drejtim vërehen disa ligjshmëri dhe kategori të moshave të cilat marrin më tepër pjesë në kryerjen e sjelljeve të ndryshme kriminale. Siç dihet, mosha e kryerësve të veprave penale, përkatësisht sjelljeve kriminale, mund të ndahen sipas përcaktimeve ligjore pozitive. Sipas ligjeve pozitive penale të vendeve të ndryshme, mosha e kryerësve të veprave penale, ndahen në mosha të personave të mitur dhe personave të rritur. Mosha e miturve ndahet në të mitur të rinj, e cila përfshinë moshën prej 14-16 vjet dhe në të mitur të rritur që përfshinë moshën prej 16-18 vjet. Kategoria e personave deri në moshën 14-vjeçare, në literaturën kriminologjike dhe juridiko penale trajtohet si moshë e fëmijëve dhe zakonisht personat e kësaj moshe nuk i nënshtrohen trajtimeve juridiko penale. Këta persona, siç dihet, nuk janë të përgjegjshëm nga aspekti juridiko-penal. Ndaj

tyre, nëse kryejnë veprimet delikvente, zakonisht ndërmeren masa të kontrollit dhe mbikëqyrjes nga ana e familjes dhe organeve të ndryshme të cilat merren me mbrojtjen dhe me kujdes social. Mirëpo, në disa shtete, në këtë drejtim bëhet edhe përjashtime. Shpeshherë, në disa shtete të Lindjes, moshë e personave prej 10-14 vjet i nënshtrohet përgjegjësisë së caktuar penale⁸⁶.

Si moshë e rritur konsiderohet moshë prej 18 e deri në vdekje të individit. Mirëpo pjesëmarrja në kriminalitet e kësaj moshe, pra moshës së rritur, nuk është njësoj në të gjitha fazat e jetës së këtyre individëve. Në literaturën kriminologjike dhe në kërkimet praktike, ndarja dhe kategorizimi i moshave të personave të rritur zakonisht bëhet në dekada, p.sh. ndahen në faza prej 10 apo 20 vjetësh, apo edhe më pak. Kësisoj flitet për moshën e personave të rritur prej 18 – 25 vjet si moshë e veçantë, pastaj moshë 25 – 30, moshë 30 – 40 vjet, moshë 40 – 50, moshë 50 – 60 dhe në fund, moshë më e vjetër se 60 vjet. Nëse ndikohen të dhënat statistikore gjyqësore dhe të dhënat nga kërkimet empirike kriminologjike në botë, vërehet se moshat më prezente në veprimet kriminale janë moshat prej 25- 30, pastaj grupi i moshës 30 – 50 dhe më pak grupi i moshës mbi 60 vjet. Vlen të theksohet se edhe moshë prej 18 – 25 është mjaft prezente dhe kjo vlerësohet si një i ashtuquajtur kriminalitet i të rinjve i cili në botën bashkëkohore tregon karakteristika të veçanta, si për nga mënyra e kryerjes, ashtu edhe për kah intensiteti i paraqitjes në veprimet kriminale⁸⁷.

Nga literatura kriminologjike dhe të dhënat nga praktika gjyqësore, del se grupet e tilla të moshave të kryerësve të veprave penale, pak a shumë janë të njëjta në të gjitha vendet e botës me dallime shumë të vogla, prej një regjioni në regjionin tjetër, e sidomos prej brezave të ndryshme klimatike në breza tjerë. Në këtë drejtim, theksohet se në brezat e nxehtë klimatike dhe shtetet të cilat gjenden në ato breze, vërehet një pjesëmarrje më e madhe e grupeve të moshave më të reja, ngase si thuhet atje, për arsye klimatike dhe biologjike, arrihet më herët pjekuria biofizike dhe biopsiqike e popullatës së re. Nga ana tjetër, në vendet Skandinave dhe në viset me klimë më të ftohtë, pjekuria biopsiqike dhe biofizike vjen më vonë, kështu që pjesëmarrja e moshave, shikuar sipas vjetëve të kryerësve të veprave penale, është më e vonshme në këto regjione. Pjesëmarrja e moshave të caktuara dallon edhe në kyqjen e tyre në kryerjen e krimeve të ndryshme. Kësisoj moshë e re merr pjesë më shumë në kryerjen e krimeve kundër pasurisë si janë vjedhjet, vjedhjet me thyerje, plaçkitjet, trafiket ilegale me narkotik etj. Ndërsa të rriturit në krimet tjera duke filluar prej krimeve kundër jetës dhe trupit, dhunimet, krimi i organizuar etj⁸⁸.

⁸⁶ Halili.Ragip,Kriminologjia,Prishtinë,2011,faqe 129-130.

⁸⁷ Po aty,faqe 130.

⁸⁸ Po aty,faqe 130.

1.1.2 GJINIA E PERSONAVE TË DËNUAR

Gjinia apo përkatësia seksuale në pjesëmarrjen e kriminalitetit gjithashtu vështrohet në literaturën kriminologjike dhe interpretohet nga këndvështrime të ndryshme. Ekziston një përshtypje e përgjithshme në bazë të dhënave të statistikës kriminale dhe praktikës gjyqësore, se kriminaliteti është një dukuri tipike e gjinisë mashkullore. Gjë që vërehet dhe është prezente edhe në vendin tonë apo gjegjësisht në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës, pasi sipas të dhënave dhe statistikave del se gjinia e cila është më aktive apo më tepër pjesëmarrëse në kriminalitet është gjinia mashkullore, dhe atë në shifra dhe numra shumë më të lartë në krahasim me gjininë femërore. Edhe për kundër faktit që kriminaliteti paraqitet si dukuri tipike mashkullore, kjo nuk nënkupton se meshkujt nuk janë viktimë. Nëse i qasemi studimeve viktimologjike do të shohim se tek veprat penale të vrasjes në të shumtën e rasteve si viktimat na paraqiten personat e gjinisë mashkullore. Mirëpo kjo nuk anashkalon edhe femrën si viktimë e krimit të vrasjes. Karakteristika e kriminalitetit të femrave është edhe fakti se ato më tepër marrin pjesë në kryerjen e krimeve si ndihmëse, shtytëse e më pak si kryerëse e drejtëpërdrejtë apo organizatore të krimeve të caktuara. Pjesëmarrjen e vogël në kriminalitet, disa autorë janë të prirur ta shpjegojnë dhe ta arsyetojnë me faktin se femra është një qenie biopsikike dhe biofizike më e ndjeshme, më e dobët në pikëpamje anatomike-fizike etj. Në këtë drejtim, veçmas theksojnë vetitë personale anatomike-psikike si p.sh.: emocionalitetin e theksuar, ciklin menstrual, shtatëzëninë, lindjet, klimateriumin etj. Të cilat ndikojnë që ajo në raste të caktuara të jetë më agresive, të ketë sulme dhe paraqitje hysterike, të bie në depresione dhe gjendje të tjera psikike të cilat objektivisht mund ta shtyjnë dhe ta nxisin në veprime dhe sjellje kriminale⁸⁹.

Në vazhdim do të paraqesim tabelën me anë të së cilës do të vërejmë gjininë e kryerësve të veprave penale në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës për vitet 2012-2018 , të dhëna të marra nga evidencat dhe statistikat që mbahen në arkivin e gjykatës:

⁸⁹ Halili.Ragip,Kriminologjia,Prishtinë,2011,faqe 131-132.

Tabela numër 3.⁹⁰

KRYERËSIT E VEPRAVE PENALE SIPAS GJINISË

Viti	Mashkull	Femër
2012	22	
2013	30	1
2014	44	
2015	58	4
2016	14	
2017	15	
2018	33	
Gjithësej	216	5



Nga të dhënat që janë të paraqitura në tabelë kemi numrat për gjinën për vitet 2012 deri vitin 2018. Gjina mashkullore si gjini që dominon në kriminalitet edhe në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës del se në vitin 2012 kemi 22 raste dhe ky numër me kalimin e viteve shkon duke u rritur dhe atë duke dyfishuar dhe bashkë me rritjen e veprës penale ndër vite arrinë shifrën në 216 raste deri në vitin 2018, nga kuptohet se kriminaliteti ka një rritje dhe shoqëria jonë është në rrezik të madh nga kjo gjinë. Mirëpo duhet theksuar se te disa sjellje kriminale dhe vepra penale

⁹⁰ Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Tetovës.

pjesëmarrja e femrës është më e vogël. Karakteristikë e kriminalitetit të femrave është edhe fakti se ato më tepër marrin pjesë në kryerjen e krimeve si ndihmëse, shtytëse e më pak si kryerëse e drejtëpërdrejtë apo oragnizatore e krimeve të caktuara.⁹¹ Me globalizimin dhe me afrimin e gjinisë femërore në shoqërinë bashkëkohore është normale dhe e pritshme se numri i kirmeve që kryejnë nga kjo gjinë do të rritet, dukuri që shihet edhe në shoqërinë tonë gjegjësisht edhe në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës, ku në vitin 2012 nga të dhënat në tabelë kemi vetëm 1 rast të dënimit për gjinën femërore dhe ky numër deri në vitin 2015 rritet në mënyrë drastike dhe kap shifrën deri 4 raste. Normalisht ky numër shkon në rritje bashkë me numrin e rritjen e veprave penale. Në rrethin që kemi paraqitur se sa është numri apo gjegjësisht përqindja e gjinive që marrin pjesë në kriminalitet, nëse bëjmë mbledhjen e veprës penale për “vrasje” komplet për të gjitha vitet kemi gjininë mashkullore me 98% pjesëmarrje dhe atë femërore me 2%.

1.2 NACIONALITETI I TË DËNUARVE ME BURGIM

Nga vet fakti se shteti jonë është shtet multinacional, apo si pjesëmarrës në kriminalitet bëjnë pjesë më tepër nacionalitete e pamë të arsyeshme dhe të rrugës që edhe nacionaliteti si karakteristik e personalitetit të dënuarve me burgim të studiohet në bazë të dhënave dhe statistikave që shfrytëzuar nga evidenca e arkivit të Gjykatës Themelore të Tetovës.


Në vazhdim në formë tabelare do të paraqesim një pasqyrë më të plotë të strukturës nacionale të dënuarve me burgim në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës prej vitit 2012 deri vitin 2018
Tabela numër 4.⁹²

Nacionaliteti i të dënuarve me burgim	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Shqiptarë	5	11	23	20	6	7	18
Maqedonas	6	/	1	4	/	/	/
Sërb	/	/	/	/	/	/	/
Turq	/	/	/	/	/	/	/
Romë	/	/	/	/	/	/	/
Boshnjak	/	/	/	/	/	/	/
Të tjerë	/	/	/	/	/	/	/
Gjithsej	11	11	24	24	6	7	18

⁹¹ Halili.Ragip,Kriminologjia,Prishtinë,2011,faqe 132.

⁹² Të dhëna nga Gjykata Themelore e Tetovës.

PËRQINDJA E TË DËNUARVE ME BURG SIPAS NACIONALITETIT



Personat e dënuar më të shpeshtë sipas të dhënave në tabelën e mësipërme janë të nacionalitetit shqiptar pastaj maqedonas. Edhe atë për brenda viteve 2012 deri 2018 për nacionalitetin shqiptar del numëri i përgjithshëm 90, për maqedonasit 11 raste.

1.3 RECIDIVIZMI

Me recidivizëm nënkuptojmë, personi i cili është dënuar një herë për vepër penale të kryer apo përsërit të njejtën ose vepër penale të llojit tjetër. Recidivizmi apo përsëritja e sjelljeve kriminale, paraqet një formë të veçantë të manifestimit të kriminalitetit, që në vete ndërlidh rrezikshmëri të posaçme shoqërore. Si lloj i tillë recidivizmi apo vet individi recidivist është problematikë i kohës bashkëkohore me të cilën merren teoritë dhe shkencat përkatësisht për përkufizimin dhe definimin në mënyrë sa më të plotë dhe më të saktë. Recidivizmi apo përsëritja e veprës penale dhe sjelljeve kriminale mund të vështrohet nga aspekti juridiko-penal, kriminologjik dhe penologjik⁹³.

Sipas **kuptimit juridiko-penal** me recidivizëm nënkuptojmë kryerjen e përsëritur të veprave penale nga ana e personit i cili ka qenë më parë i dënuar për ndonjë vepër penale. Kjo pikëpamje mbi recidivizmin nisët nga kriteret formale-juridike, duke marrë parasysh faktin se kryerësi i veprës penale pas aktgjykimit të plotëfuqishëm kryen përsëri vepra penale. Në këtë drejtim, disa autorë theksojnë se këtu duhet bërë njëfarë dallimi duke marrë parasysh intervalin kohor në mes veprës së

⁹³ Halili.Ragip,Kriminologjia,Prishtinë,2011,faqe 229.

mëparme dhe veprës së re. Mirëpo, kur shtrohet nevoja e caktimit konkret të këtij intervali kohor mes autorëve ka mendime të ndryshme⁹⁴.

Në literaturën juridike-penale flitet për recidivizmin në kuptimin e ngushtë dhe për recidivizëm në kuptimin e gjerë, ose recidivizmin e përgjithshëm. Te forma e parë e recidivizmit, kemi të bëjmë me përsëritjen e dy e më shumë veprave të njëjta ose të ngjajshme penale, ndërsa te forma e dytë, kemi të bëjmë, me përsëritjen e veprave penale në përgjithësi. Forma e parë e recidivizmit, ose recidivizmi special, konsiderohet si formë më e rrezikshme pasi që te kryerësit vërehet një lloj përsosjeje në kryerjen e veprave penale dhe krijimin e shprehive për krime të ngjajshme. Në trajtimet juridiko-penale dhe kriminologjike shpeshherë flitet për të ashtuquajtur recidivizëm të zakonshëm dhe të shumëfishtë. Recidivizmi i zakonshëm është kur bëhet përsëritja e veprës penale më shumë se njëherë. Ndërsa, te format e recidivizmit të shumëfishtë, kemi të bëjmë me kryerjen e dy e më shumë rasteve të veprave penale disa herë, për një interval të caktuar kohor. Në bazë të dispozitave juridiko-penale pozitive të vendeve të ndryshme, bëhet fjalë për trajtimin në praktikë të personave recidivist gjatë matjes së përgjegjësisë penale dhe caktimit të dënimit. Gati në të gjitha dispozitat pozitive juridiko-penale institohet që gjykatat të marrin rrethanat e përsëritjes së veprave penale, si rrethana të cilat tregojnë rrezikshmërinë e kryerësit dhe nevojën që ndaj tij të aplikohen masa dhe sanksione më të ashpra. Po ashtu, ndaj recidivistëve, edhe në entet ndëshkimore-përmirësuese dhe edukative-përmirësuese, shtrohet nevoja e aplikimit të një tretmani të posaçëm, me qëllim të riedukimit dhe risocializimit më të suksesshëm të tyre. Mirëpo, në literaturën kriminologjike ka edhe mendime të tjera të cilat theksojnë se rrethanë e përsëritjes, pra recidivizmi, nuk duhet të konsiderohet automatikisht si rrethanë rënduese dhe si pretekst për shqiptimin e dënimeve më të rënda dhe ashpërsimin e tretmanit penitensiar ndaj tyre. Kjo, më parë, theksojnë ato, duhet të paralajmërojnë edhe teorinë edhe praktikën, së ndaj recidivistëve duhet të ndërmerren masa tjera, sidomos masa të shërimit, masa preventive e jo dënime më të ashpra⁹⁵.

Sipas **kuptimit kriminologjik**, recidivizmi nënkupton përsëritjen e sjelljeve kriminale dhe delikuate të një personi pa marrë parasysh se a ekziston më parë gjykimi i plotëfuqishëm, ose pa marrë parasysh se a është mbajtur dënimi për veprat e mëparshme penale. Këtu me rëndësi është vetë fakti i përsëritjes si kategori sociale ose si raport psikosocial me veprimet dhe sjelljet kriminale të recidivistit. Botëkuptimi i recidivizmit si përsëritje e sjelljeve të dëmshme dhe të rrezikshme në shoqëri, ka të bëjë me faktin se ai flet për dukurinë e recidivizmit si shprehje dhe sëmundje e disa individëve ndaj të cilëve duhet ndërmarrë masa të tjera e jo vetëm masa juridikopenale. Aspekti dhe trajtimi kriminologjik i recidivizmit dhe recidivistëve, konsiston në kërkesat për studimin e

⁹⁴ Halili.Ragip,Kriminologjia,Prishtinë,2011,faqe 229-230.

⁹⁵ Po aty,faqe 230.

personalitetit të tyre, për analizën dhe ndriçimin e vetive të ndryshme psikike dhe sociale. Në rend të parë insistohet që personaliteti i delikuentit recidivist të studiohet nga të gjitha aspektet, në mënyrë që të shpjegohen shkaqet e vërteta të sjelljes së tyre kriminale. Në këtë drejtim, posaçërisht kërkohet të bëhet hulumtimi dhe studimi i të ashtuquajturit delikuent recidivist nga shprehite, tendenca dhe recidivistët profesional⁹⁶.

Sipas **kuptimit penologjik**, me recidivizëm nënkuptojmë ardhjen e sërishme të kryerësit të veprës penale në ente ndëshkimore-përmirësuese apo edukative-përmirësuese. Pra, këtu kemi të bëjmë me persona të cilët në institucionin ndëshkivor përmirësues apo edukativo-përmirësues vijnë dy e më tepër herë për shkak të përsëritjes së veprave penale. Ardhja e sërishme në entin ndëshkivor-përmirësuese, vetvetiu shtron pyetjen: a thua tertmani i mëparshëm edukativo-përmirësues ka qenë adekuat dhe në rregull. Kjo flet se procesi, mjetet, metodat dhe mënyrat e risocializimit dhe riedukimit nuk ka qenë e favorshme dhe nuk ka kontribuar në riedukimin e personit recidivist. Për këtë arsye, në praktikën penitensiare nëpër entet e ndryshme ndëshkimore-përmirësuese, shpeshherë, themelohen paralele të veçanta për personat recidivistë ndaj të cilëve aplikohet një tretman i veçantë. Mirëpo, pa marrë parasysh këtë, ekziston bindja se në shumë vende trajtimi i recidivistëve nëpër entet ndëshkimore-përmirësuese nuk është në nivel të duhur, e veçmas mungon observimi dhe studimi i gjithanshëm i personalitetit të tyre. Kjo shpeshherë, konsiderohet si dobësi e cila pengon riedukimin dhe risocializimin e suksesshëm të tyre dhe nxit ardhjen e sërishme të personave të tillë në institucione korrektuese-përmirësuese⁹⁷.

1.2.1 Faktorët që ndikojnë në paraqitjen e recidivizmit

Në paraqitjen e recidivizmit si formë e veçantë e kriminalitetit, sipas të dhënave nga literatura kriminologjike, ndikojnë shumë faktorë. Këta faktorë mund të jenë të natyrës objektive dhe subjektive. Mirëpo, vetë fakti se personat recidivistë përsërisin disa herë veprën penale, vetë fakti se dënimet dhe masat e aplikuara ndaj tyre nuk kanë dhënë rezultate në drejtim të përmirësimit dhe risocializimit të tyre, parashtron nevojën e theksimit të disa faktorëve të veçantë subjektivë që ndikojnë në veprimet dhe sjelljet e tyre kriminale. Këta faktorë, shpeshherë lidhen me disa veti dhe sjellje të natyrës individuale dhe subjektive, me të ashtuquajtur faktorë të brendshëm të sjelljes kriminale. Në këtë drejtim, në literaturë përmenden edhe faktorë të jashtëm që ndikojnë në sjelljen kriminale të recidivistëve. Këto janë rrethanat joadekuate familjare, konfliktet në familje, varfëria, papunësia, konsumimi i alkoolit dhe drogës etj. Po ashtu, theksohet edhe arsimimi dhe edukimi

⁹⁶ Halili.Ragip,Kriminologjia,Prishtinë,2011,faqe 230.

⁹⁷ Po aty,faqe 230-231.

joadekuat nëpër institucione shkollore. Posaçërisht si factor i jashtëm, nga disa autorë përmenden edhe ndikimi negative i qëndrimit në burgje dhe ente ndëshkimore-përmirësuese⁹⁸.

Personat delikuentë recidivistë, kryesishtë dallohen me disa cilësi dhe veti të caktuara të cilat, sipas mendimeve të autorëve të ndryshëm, i shtyjnë në kryerjen e veprave penale. Kësisojë, theksohet se recidivistët janë persona të frustuar, persona të cilët vështirë adaptohen në mjediset e caktuara, persona që janë të prirur t'i nënshtrihen ndikimeve të llojllojshme, persona të cilët vuajnë nga komplekset e ndryshme, si kompleksi i inferioritetit, personat te të cilët është i pranishëm jostabiliteti emocional dhe frika permanente nga problemet jetësore etj. Këta persona, posaçërisht u nënshtrihen ndikimeve të mjeteve të komunikimit publik, sidomos shtypit revyjal, filmave dhe programeve televizive me përmbajtje të dyshimta, ngase ata nuk kanë aftësi t'i kuptojnë dhe interpretojnë drejt. Lidhur me shkaqet e përsëritjes së veprave penale te këta persona, theksohet edhe momenti i marrjes me sjellje kriminale në rininë e hershme. Kështu, në mesin e recidivistëve, shpeshherë hasëm persona të cilët "karrierën" kriminale e kanë filluar qysh nga koha më e hershme e fëmijërisë së tyre. Format e sjelljeve asociale dhe delikente të tyre, në fillim kanë qenë ikja nga shtëpia, ikja nga shkolla, bredhja e pakontrolluar poshtë e lartë, shoqërimi me grupe dhe banda të miturve e pastaj marrja me vjedhje të imta dhe kryerja e formave të rënda të sjelljeve kriminale⁹⁹.

Recidivistët, për nga struktura e tyre, pa marrë parasysh se në shikim të parë lënë përshtypje se deri diku, të gjithë janë njësoj, dallohen shumë njëri me tjetrin dhe nuk përbëjnë grupe homogjene. Ato dallohen në mes veti sipas vetive të caktuara sociale, psikike, anatomike-fizike etj. Gati çdo rast i recidivizmit është rast në vete dhe nënkupton një qasje të veçantë të studimit dhe analizës. Kriminologu francez Zhan Pinatel, të gjithë recidivistët i ndan në tri grupe: në recidivist profesional, të paadaptuar dhe të rastit. Autori tjetër R.Cavan, në punimin e tij "Criminology", dallon katër tipe recidivistësh: profesionalë, të "jakës së bardhë", të lehtë dhe të përzier¹⁰⁰.

Recidivizmi si formë e veçantë e kriminalitetit, ka pasoja të rënda dhe në bazë të shënimeve statistikore, konsiderohet se ai merr pjesë në kriminalitetin e përgjithshëm, varësisht prej llojeve të veprave penale prej 20-60%. Vëllimi dhe pjesëmarrja e recidivizmit, pa marrë parasysh përqindjet e theksuara qartë tregon se kjo formë e kriminalitetit paraqet rrezik të veçantë dhe se sinjalizon për pa aftësinë e shoqërisë që me sukses të pengojë kriminalitetin në botën bashkëkohore¹⁰¹.

⁹⁸ Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, faqe 231.

⁹⁹ Po aty, faqe 231-232.

¹⁰⁰ Po aty, faqe 232.

¹⁰¹ Po aty, faqe 232.

2. TENTATIVA E VEPRËS PENALE

Sipas KPM (n.19 p.1) “Ai i cili me paramendim do të fillojë kryerjen e veprës penale, por nuk do ta mbarojë, do të dënohet për tentim të veprës penale”. Tentimi **është vepra penale e filluar por e pambaruar**, fillimi me paramendimi me kryerje të veprës që ka mbetur e pakryer për shkak të ndonjë arsye, pavarësisht nga dëshira e kryerësit! Me këtë në fakt është dhënë nocioni i tentimit të pasuksesshëm, si formë themelore e tentimit, ku ligji e ndan tentimin e papërshtatshëm dhe heqjen dorë vullnetare. Për të gjitha këto forma të veprës së filluar dhe të pambaruar, është karakteristike munges e pasojës së veprës. Vetëm se te forma themelore e tentimit të pasuksesshëm, pasoja ka munguar kundër dëshirës së kryerësit (gabim në gjuajtje, fizikisht i penguar për ta kryer veprën etj), te tentimi i papërshtatshëm sepse ajo nuk ka mundur të jetë e nxitur me mjet të papërshtatshëm ose kundër mjetit të papërshtatshëm dhe te heqja dorë vullnetare – sepse kryerësi vullnetarisht është tërhequr prej kryerjes së veprës¹⁰².

Dënimi për tentim do të thotë **zgjerim i zonës së dënimit** i përcaktuar me dispozitat e veprave më të rënda në pjesën e posaçme, për të cilët është paraparë dënim me burgim deri me pesë vjet ose dënim më i rëndë te veprat më të lehta të përcaktuara me ligj. Figurat e tyre ligjore janë të konsumuara sipas modelit të veprës së kryer (ai i cili do të bëjë para të falsifikuara me qëllim që t’i lëshojë në qarkullim si të vërteta – te falsifikimi i parave; ai i cili personit zyrtar do t’i jap ose do t’i premtojë dhuratë – te ryshfeti/korrupsioni etj). Pa dispozita të dënimit të tentimit, kryerësi mund të dënohet vetëm nëse me veprën e tij janë realizuar të gjitha tiparet e veprës penale, duke i përfshirë edhe deliktet materiale dhe shfaqjen e pasojës! Tentimi, përkundër kësaj është formë e shkurtuar e veprës penale që shtresat në vetë fillimin e kryerjes së veprës dhe kjo do të thotë se linja e dënimit kalon në fazën e më hershme para mbarimit të veprës! Prej këtui, pas nocionit ligjor të tentimit fshihet problematika e ndërlikuar që reflekton nëpërmjet optikës së posaçme, mësimin për figurën e veprës dhe për fazat (stadiumet) e realizimit të saj¹⁰³.

Teoritë objektive të përfaqësuar në literaturën e vjetër (që në kohën e Feurbach), nisen prej qëndrimit se fillimi me kryerjen e veprës duhet të dënohet sepse ajo e rrezikon objektin e veprimit të përfshirë me figurën ligjore. Shkalla e lartë e mundësisë se do të vijë deri te pasoja e realizuar me veprimin e kryerjes, është kriter material pa të cilin nuk do të mund të tërhiqet as kufiri mes fazave (stadiumeve) të kryerjes së veprës. Dallimi mes veprimeve përgatitore, tentimit dhe veprës së kryer sipas kësaj nuk mund të realizohet në mbështetje të elementit subjektiv që ato plotësisht i nivelizon –paramendimin e kryerësit. Koncepti objektiv nuk është i pranuar as prej ligjvënësist tonë i cili

¹⁰² Kambovski.Vllado,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup,2010,faqe 325.

¹⁰³ Po aty,faqe 325.

(n.19) e definojnë tentimin duke e theksuar edhe elementin objektiv por edhe atë subjektiv – paramendimin e kryerësit¹⁰⁴.

Teoritë subjektive, si bazë të vetme e theksojnë dëshirën kriminale të kryerësit. Secili veprim që është tregues i asaj dëshire duhet të trajtohet si tentim. Nëse pasoja shumë shpesh nuk shfaqet për shkak të rrethanave të rastësishme (p.sh. dikush ka gjuajtur pas dikujt për ta vrarë dhe e ka lënduar, por në vendin e ngjarjes është mjeku dhe ia ka shpëtuar jetën), atëherë nuk ka arsye për tentimi të dënohet ndryshe prej veprës së kryer. Asnjë plan subjektiv nuk mund t'i jep një veprimi karakter të veprimit të kryer ose të fillimit të veprës së tillë, nëse ajo nuk është e përfshirë me përshkrimin ligjor të veprës¹⁰⁵.

Teoritë objektive-subjektive (të përziera), e theksojnë rëndësinë e bazueshmërisë objektive dhe subjektive të dënimit të tentimi, duke e kaluar qasjen e njëanshme të koncepteve të theksuara më herët. Tentimi dënohet për shkak të fillimit me veprimin e kryerjes, dëshirës kriminale të paraqitur të kryerësit. Ky koncept është i pranuar në teorinë dhe në legjislacionin bashkëkohor dhe për të njëjtin përcaktohet edhe ligjvënësi ynë nëpërmjet definicionit të tentimit si paramendim në fillimin e veprës që duhet të kryhet, dënimin e tentimit të papërshtatshëm dhe zbutjen e dënimit të tentimit! Sipas këtij koncepti, fillimi me veprimet e kryerjes që personifikon dëshirën e kryerësit për realizim të pasojës, përmban shkallë të majftueshme të padrejtësisë që të mund të trajtohet si vepër penale (e pakryer). Konsekuenca e këtij mësimi është edhe theksimi i kriterit objektiv-subjektiv për kufizim të tentimit prej veprimeve përgatitore¹⁰⁶.

Figura e tentimit – Definicioni ligjor i tentimit përmban tre elemente: paramendimi për kryerje të veprës penale, fillimi i kryerjes së veprës dhe mosshfaqja e pasojës së tij! Por ky definicion ligjor haptas transcendon në figurën ligjore të veprës së caktuar penale; bëhet fjalë për paramendim për vepër të caktuar etj. Kjo do të thotë se tentimi nuk ka vetë për vete figurë të posaçme ligjore, por gjithëmonë lajmërohet si **figurë e shkurtuar e veprës** së caktuar penale. Pa përcaktimin e tentimit, vetë fillimi i kryerjes së veprës penale do të mbetet i padënuar. Mësimi për figurën e tentimit ballafaqohet me pyetjen fillestare – cila është ajo vepër penale me të cilën duhet të vjen në lidhje nocioni transcendent i tentimit? Nëse gjithmonë kemi tentim për vrasje, tentim për vjedhje etj., si do të vijmë deri te figura ligjore konkrete? Ose më mirë – si do ta dimë nëse veprimi i caktuar i cili vetë për vete nuk ka asnjë kualifikim të mëparshëm juridik, është fillimi me kryerjen e veprës penale dhe i cilës vepër? Në ligjeratën për fazat (stadiumet) e veprës penale, pamë se përgjigjja në një pyetje të bërë nuk mund të kërkohet në natyrën objektive të veprimit dhe se i njëjti veprim mund të gjendet shpeshëherë si tentim, shpesh si përgatitje dhe shpesh si veprim që nuk ka asnjë lidhje

¹⁰⁴ Kambovski,Vllado,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup,2010,faqe 325.

¹⁰⁵ Po aty,faqe 326.

¹⁰⁶ Po aty,faqe 326.

me ndonjë vepër penale. Përkundër kësaj, vendimtare është gjithëmonë drejtueshmëria subjektive e veprës. Deri te figura ligjore me të cilën mund të ndërlidhet vepra e caktuar, vijmë ekskluzivisht në bazë të paramendimit, qëllimit ose planit kriminal të kryerësit. Drejtimi i veprës kah realizimi i veprës konkrete nuk varet prej qëndrimit personat të kryerësit (i cili mund të llogaritet gabimisht se ndërmer vepër përgatitore dhe jo tentim ose anasjelltas), por prej paramendimit të tij i objektizuar nëpërmjet veprimit të jashtëm që është i paraparë si veprim i kryerjes së veprës së caktuar¹⁰⁷.

Elementi subjektiv në figurën e tentimit është parandalimi i kryerjes së veprës. Ana subjektive e figurës së veprës së kryer: kryerësi është i vetëdijshëm për të gjitha tiparet dhe e dëshiron ose pajtohet me shfaqjen e pasojës. Nuk ekziston tentim nëse kryerësi nuk ka dëshirë të fortë për shkaktim të veprës, nëse paramendimi i tij është i kufizuar vetëm në fillimin me veprim të caktuar pa vetëdije të qartë dhe dëshirë për pasojën e tij (p.sh. e ka nxjerrë revolverin që të gjuaj, por pa vullnet që të vrasë dikë, në këtë rast mund të bëhet fjalë për vepër, rrezikimi i sigurisë nga n.144 KPM). Nga ana tjetër, do të bëhet fjalë për tentim kur paramendimi i kryerësit nuk ka qenë i detajuar, por paraqitet si i përgjithshëm dhe i papërcaktuar (p.sh. ekziston vjedhje kur kryerësi do të hyjë në banesë të tjetrit pa e ditur saktë se çka dëshiron të vjedhë ose me qëllim që të marrë gjithcka çka është e vlefshme). Te veprat, figura ligjore e të cilave përfshinë elemente të posaçme subjektive (qëllimin, tentimin) dhe plotësimin e elementit të tillë subjektiv, është i domosdoshëm për ekzistimin e tentimit (kështu p.sh. nuk ka tentim për vjedhje nëse dikush uzurpon sendin e huaj, por pa qëllim përvetsimi). Nëse kryerësi e fillon veprën, por me qëllim që pastaj të tërhiqet dhe ta pengojë kryerjen e saj, nuk do të bëhet fjalë për tentim, sepse nuk ka dëshirë për mbarim të veprës¹⁰⁸.

Elementi i **dytë objektiv** i figurës joindividuale të tentimit është fillimi i kryerjes së veprës. Kryerësi fillon me kryerjen e veprës kur e ndërmer veprimin e kryerjes së përmbajtur në përshkrimin e tij ligjor. Në diskutimet për veprimin e kryerjes, pamë se ajo mund të jetë e paraparë (përshkruan) drejtëpërsëdrejti (ai i cili do të hyjë pa autorizim në shtëpinë e huaj) ose indirekt, përmes përshkrimit të pasojës që mund të jetë e nxitur me cilindo veprim (ai i cili do të shkaktojë lëndime trupore tjetrit) që është veprimi i vrasjes, p.sh. ligji nuk tregon – edhe më pak kur ajo fillon. Përshkrimi ligjor mund të përmbajë dy veprime kumulative (te dhunimi: veprim i dhunshëm dhe marrëdhënie seksuale me dhunë) ose më shumë veprime alternative (mbyllja, shoqërimi i të burgosurve etj., te heqja kundërligjore e lirisë); veprimi mund të jetë i përshkruar edhe me ndihmën e klauzulës gjenerale (bartja e sëmundjes ngjitëse përmes veprimit seksual ose në mënyrë tjetër), ose në atë mënyrë që do të konkretizohen mënyra, mjetet, vendi ose koha e kryerjes. Përcaktimi

¹⁰⁷ Kambovski.Vllado,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup,2010,faqe 326-327.

¹⁰⁸ Po aty,faqe 327.

preciz i elementit objektiv është i rëndësishëm, sepse me të tërhiqet linja e kufizimit mes tentimit parimor të dënuar të të gjitha veprat e rënda dhe parimi i mosdënueshmërisë së veprave përgaditore¹⁰⁹.

2.1 Dallimi midis veprimeve përgaditore dhe tentativës

Definicioni i përgatitjes (n.18 p.3 KPM) si veprim me të cilin krijohen kushte për kryerjen direkte të veprës dhe të cilët nuk paraqesin veprime të kryerjes, nga njëra anë dhe ana tjetër e tentimit si fillim i kryerjes së veprës nuk mund ta plotësojnë nuancat kalimin prej faze më të vogël kah ajo më e lartë dhe të sigurojnë prerje relevante penalo-juridik të sjelljes së shpeshtë kompleksive të kryerësit. Por sado që teknika legislative të dështojë në gjetje të ndonjë zgjidhjeje më të mirë për tentimin (në të gjitha legjislacionet është e shfrytëzuar lartë poshtë formula e njëjtë e fillimit të kryerjes), padyshim është se ky kufizim nuk guxon t'i lihet vlerësimit diskrecional të gjyqit, sepse kjo do të thotë rrezikim serioz të parimit të ligjshmërisë dhe i sigurisë juridike¹¹⁰.

Atë që nuk mund ta bëjë ligjëvënësi, për detyrë e merr ta përmirësojë dhe plotësojë dogma penalo-juridik. Në këtë kuptim janë zhvilluar disa qasje teorike. Më respektiv është ai i **teorisë objektive-formale**, sipas së cilës gjithëmonë duhet të nisët prej përshkrimit ligjor të veprimit të kryerjes. Duke e marrë në konsideratë faktin se përshkrimi ligjor i veprimit është i gjeneralizuar, ky mësim insiston që konkretizimi i fillimit të saj të mbetet në kornizat e përshkrimit ligjor tekstualisht. Të marrim shembull vrasjen e kryer me helmim; sipas qasjes formale – objektive, si fillim i kryerjes nuk mund të merret dhënia dhe prirja e helmit, por momenti kur helmi do të fillojë të hyjë nëpër enët e gjakut dhe të shpërndahet nëpër organizëm, sepse atëherë aktivizohet procesi organik që mund të përfundojë me vdekje. Secili veprim para fillimit të absorbimit të helmit është veprim përgaditor. Ky mësim sipas kësaj mund t'i mbulojë vetëm rastet e rralla në të cilat ligji e definon veprimin e kryerjes me përdorim të shprehjeve precize juridike-teknike, të cilat nuk lënë hapësirë për interpretim më të gjerë kauzal – dhënia e deklaratës së rrejshme (n.367 LPM) fillon me dhënien e deklaratës së dëshmitarit sipas rregullave precize të LPP; ose tentim për të falsifikuar dokumente (n.378) është fillimi me përmirësimin e dokumentit të vërtet (me vijën e parë që kryerësi do të fillojë ta tërheqë në tekstin e dokumentit të vërtetë).¹¹¹

Sipas teorisë objektive-materiale, fillimi i kryerjes së veprës duhet t'i përfshijë të gjitha veprimet që sipas një kuptimi të përvojës jetësore paraqesin njësi natyrore, se si njësi të tilla prodhojnë pasojë të caktuar. P.sh. kur dikush gjuan në dikë në kuptimin më të ngushtë formal – objektiv, veprimi i kryerjes së vrasjes fillon prej momentit të hyrjes së projektilit në tupin e

¹⁰⁹ Kambovski.Vllado,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup,2010,faqe 327.

¹¹⁰ Po aty,faqe 328.

¹¹¹ Po aty,faqe 328.

viktimës. Por e pakontestueshme është se atij i paraprijnë dhe në mënyrë natyrore është i lidhur me vetë aktin e aktivizimit të tij me tërheqje të sustës, të këtij veprimi – marrja në shënjë dhe të shënjëzimit – ngritjen e armës dhe drejtimin e saj kah viktima. Të gjitha këto aktivitete janë të lidhura në mënyrë natyrore, kështu që secila nga këto pasues, doemos e përfaqëson të parën. Bëhet fjalë për pjesë të veprimeve që rrjedhin në kontinuitetin kauzal dhe që funksionojnë të varura prej njëra tjetrës. Kjo është teoria e vetme që mundëson që nocioni i tentimit ta mbulojë edhe rastin e tentimit të gabuar (kryerësi ka gjuajtur por ka gabuar), ku bëhet fjalë për veprim me të cilin vetë për vete vepra nuk do të mund të jetë e kryer (p.sh. kur ka qenë i penguar të gjuajë pasi që e ka ngritur armën: askush nuk mund të jetë i vrarë vetëm me këtë veprim). Duke i përfshirë veprimet që i paraprijnë veprimit të kryerjes si kusht i domosdoshëm për t'u ndërmarrë, ky mësim tërheq një linjë më përvojë, objektive, por relativisht të sigurt të kufizimit prej veprimeve përgaditore, të cilat mbesin nga ana tjetër e natyrës së tillë unitare! Në këtë kuptim duhet të trajtohen si përgatitje dhe jo si tentim veprimet si: shkuarje me mjetet për kryerjen e vjedhjes kah vendi ku duhet të bëhet, pritja në kurth të personit i cili duhet të sulmohet, fshehja në muze për shkak të vjedhjes së ekspozateve pas mbylljes etj. Por edhe kjo teori është akoma larg prej mbylljes së të gjitha pyetjeve, pse ajo që i lidhë veprimet e ndryshme në unitet natyror, është qëllimi dhe palni i kryerësit. Pa elementin e tillë subjektiv nuk mund të sqarohet nëse dhe cilat veprime janë të domosdoshme reciprokisht dhe të lidhura në mënyrë natyrore. Atëherë, kur të konstatohet se çka ka dëshiruar të arrijë kryerësi, mund të ketë përgjigje në pyetjen – nëse ngritja e armës është pjesë e mëtejshme prej tij e paramenduar, procesi i realizimit të veprës (dhe cila vepër). Plani i kryerësit i bashkon në unitet jo vetëm veprimet e ndërmarra, por edhe veprimet që do të ndërmerren edhe e kompletton shfaqjen për të – nëse dhe cilat vepra të reja janë të domosdoshme, të lidhura mes veti në mënyrë natyrore¹¹².

Në kuptimin penalo-juridik bashkëkohor, gjithnjë më i madh është numri i përfaqësuesve të **teorisë individuale-objektive**. Sipas kësaj teorie, fillimi me kryerjen e veprës penale do të thotë ndërmarrje të veprimeve që sipas mendimit të kryerësit është lidhur ngushtë në mënyrë natyrore me realizimin e figurës së veprës dhe që është në mënyrë të mjaftueshme e lidhur me realizimin e saj! Elementi subjektiv, plani i kryerësit i lidh veprimet e përgatitjes dhe tentimit në unitet natyror. P.sh. vendosja e minës këmbësorike në rrugë ku duhet të kalojë policia është fillimi i kryerjes së veprës – vrasje, edhe pse veprimi i tillë i paraprinë kryerjes së drejtëpërdrejtë të veprës që mund të vijë pas një kohe. Sipas mendimit të kryerësit, pas ndërmarrjes nuk është i nevojshëm veprimi plotësues që do ta ndërpriste lidhjen natyrore mes veprimit të mëparshëm dhe realizimit të figurës së veprës. Nëse sipas mendimit të tij duhet edhe ndonjë veprim tjetër, lidhja natyrore ndërpritet edhe veprimi i më parshëm do të llogaritet si përgaditor. Do të bëhet fjalë për veprime përgaditore

¹¹² Kambovski.Vllado,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup,2010,faqe 328-329.

p.sh. kur kryerësi i cili ka qëllim të kryejë vjedhje në ndonjë shtëpi një ditë më parë do ta vrasë qenin ose do të përgaditë çelës të rrejshëm me të cilin do ta kryejë vjedhjen; nuk ka tentim për falsifikim të dokumentit, por vetëm veprim përgaditor nëse kryerësi merr blanko çek që ka qëllim të aplotësojë më vonë; a do të bëhet fjalë për përgatitje ose tentim për dhunim, kur kryerësi me mashtrim e ka sjellë viktimën në banesë, varet prej asaj nëse e ka mbyllur derën ose ka ndërmarrë aktivitet tjera që lidhen me veprimin e dhunimit të tij¹¹³.

Koncepti individual-objektiv është i pranuar (i përgjigjet edhe mësimit objektiv-subjektiv të tentimit), por kërkon edhe një modifikim të domosdoshëm për shkak të zgjidhjes së problemit të mospërputhjes së mendimit të kryerjes me rrjedhën e vërtetë të ngjarjes: A do të bëhet fjalë për tentim nëse kryerësi llogaritet se veprimi i ndërmarrë mjafton për realizimin e veprës dhe ajo nuk është ashtu? Duhet d.m.th. veprimet e ndërmarra në kuptimin objektiv ta arrijnë këtë shkallë të potencialit kauzal, që pa intervenim plotësues të kryerësit të mund ta sjellin në shfaqje pasojën. Kështu p.sh. nëse kryerësi vendos bombë të tempura që duhet të eksplodojë pas disa orëve, ky është tentim sepse gjithçka që do ngjajë mëtej është punë e mekanizmit të orës. Nëse e ka vendosur që ta aktivizojë më vonë dhe ajo vetë prej vetes nuk ka mundur të aktivizohet – do të bëhet fjalë për veprim përgaditor¹¹⁴.

2.2 Ndëshkimi i tentativës

Tentativa dënohet si vepër e përfunduar të gjitha veprat e rënda për të cilat është i paraparë dënim me burgim deri në pesë vjet ose dënim më të rëndë, si dhe për vepra tjera kur ligji parasheh tentim edhe për dënim (n.19 p.1 KPM). Si vepra për të cilët është i paraparë dënimi me burgim deri në pesë vjet, llogariten edhe veprat të cilat dënimi është i paraparë si maksimum i posaçëm, sepse në këtë rast mund të shqiptohet edhe dënim maksimal (kështu te veprat e rënda të lëndimit trupor (n.131 p.1): dënim me burgim prej gjashtë muaj deri pesë vjet). Në pjesën e posaçme, për shkak të rëndësisë së posaçme të objektit të mbrojtjes dhe për nevojën e inkriminimit të fazës fillestarë të rrezikimit të tij, dënimi i posaçëm për tentim është i paraparë te më shumë vepra (kështu p.sh. të mbytja e fëmijës gjatë lindjes n.127, heqje e lirisë në mënyrë kundërligjore n.140 etj). Kryerësi dënohet për tentativën në kufijtë e dënimit të paraparë për veprën penale, por mund të dënohet edhe më butë (n.19 p.2).¹¹⁵

¹¹³ Kambovski.Vllado,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup,2010,faqe 329-330.

¹¹⁴ Po aty,faqe 330.

¹¹⁵ Po aty,faqe 330.

2.3 Rastet e posaçme të tentativës

Definimi i tentimit si fillimi i realizimit (kryerjes) të veprës penale që kryerësi nuk do ta përfundojë me rregull, nënkupton ngecje (mungesë) e pasojës, gjegjësisht tentim te deliktet materiale. Por nuk është i përjashtuar tentimi edhe te delikti formal, kur prej natyrës së veprimit të kryerjes del se ajo nuk është e kryer me vetë ndërmarrjen. Kështu p.sh. nuk është i mundshëm tentim te deliktet verbale të ofendimit dhe shpifjes, të cilat janë të kryera me vetë shprehjen e të pavërtetave ose me dhënien e deklaratave ofenduese. Por përkundër kësaj mund të mbetet në tentim dhënia e deklaratës së rrejshme (n.367 KPM) kur p.sh. dëshmitari ka filluar të japë dëshmi të rrejshme, por dëgjimi i tij nuk ka përfunduar dhe duhet të vazhdojë në seancën tjetër. Tentimi i veprës së kualifikuar nënkupton që së bashku me fillimin e veprimit, të jetë e realizuar edhe rrethana e posaçme kualifikuese e veprës (p.sh. tentim për vrasje për shfrytëzim personal n.123 p.2). I mundur është edhe tentimi i veprës, e kualifikuar me pasojë të rënd: p.sh. me vetë fillimin e shfrytëzimit të jetë nxitur pasojë e rënd e dhunimit (n.186 p.2). Në rastet në të cilat është i pranuar kombinimi i veprës themelore me paramendim edhe pasoja më e rëndë paramenduese, por nuk është i paramendur tentimi për veprën kualifikuese me pasojë më të rëndë edhe kur kryerësi duke e mbaruar veprën kryesore ka tentuar ta nxisë pasojën e tillë¹¹⁶.

Delikti garantues omisiv mbetet në tentim kur garanti ka filluar ta lëshojë obligimin e tij garantues për pengimin e pasojës (nëna nuk e ushqen fëmijën me qëllim që ta vrasë, por fëmija është shpëtuar nga të tjerët). Për fillim të lëshimit duhet të merret momenti i aktualizimit të gjendjes së rrezikshme që pa vonesë e obligimit garantues. Tentimi i deliktit të omisiv mund të paraqiten në formë të tentimit të pavolitshëm (papërshtatshëm) - (p.sh. nëse vozitësi largohet nga vendi i fatkeqësisë së komunikacionit, duke menduar se personin që e ka lënduar është akoma gjallë – tentim i padënuar i papërshtatshëm për veprën – n.301). I mundur dhe i dënuar, siç do të shohim është tentimi për nxitje (jo edhe për ndihmë) si dhe tentimi për kryerje direkte dhe bashkëkryerje¹¹⁷.

¹¹⁶ Kambovski.Vllado,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup,2010,faqe 331.

¹¹⁷ Po aty,faqe 331-332.

KREU I KATËRT

ANALIZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE, DËNIMI ME BURG, ANALIZA POLITIKE.

1. ANALIZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE TË PËRGATITIURA NGA ANA E GJYKATËS THEMELORE NË TETOVË

Në vijim do të shfaqim disa të dhëna nga ana e Gjykatës Themelore në Tetovë:

Tabela numër 5.¹¹⁸

Gjyqtar	Numri i lëndës	Lloji i veprës penale	Vendim
Verka Kostobska	K-592/12	Vrasje	Aktgjykim dënues
Zorica Eftimovska	K-287/12	Vrasje	Dënim me burg
Jordan Velkovski	K-58/12	Vrasje	Dënim me burg
Lidija Ilievaska	K-182/12	Vrasje	Dënim me burg
Lidija Ilievaska	K-239/12	Vrasje	Dënim me burg

Nga të dhënat që janë paraqitur në tabelën e sipërme, për vitin 2012, që u është shqiptuar dënim me burg.

Tabela numër 6.¹¹⁹

Gjyqtar	Numri i lëndës	Lloji i veprës penale	Vendim
Zorica Eftimovska	K789-/13	Vrasje	Dënim me burg
Jordan Velkovski	K1-/13	Vrasje	Dënim me burg
Lidija Ilievaska	K-303/13	Vrasje	Dënim me burg
Nazif Iljazari	K-667/13	Vrasje	Dënim me burg

Nga të dhënat që janë paraqitur në tabelën e sipërme, për vitin 2013, që u është shqiptuar dënim me burg.

¹¹⁸ Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Tetovës.

¹¹⁹ Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Tetovës.

Tabela numër 7.¹²⁰

Gjyqta	Numri i lëndës	Lloj i veprës penale	Vendim
Betim Jahja	K-433/14	Vrasje	Dënim me burg
Verka Kostobska	K-117/14	Vrasje	Dënim me burg
Verka Kostobska	K-211/14	Vrasje	Dënim me burg
Verka Kostobska	K-777/14	Vrasje	Dënim me burg
Verka Kostobska	K-787/14	Vrasje	Dënim me burg
Zorica Eftimovska	K-216/14	Vrasje	Dënim me burg
Zorica Eftimovska	K-543/14	Vrasje	Dënim me burg
Zorica Eftimovska	K-847/14	Vrasje	Dënim me burg
Jordan Velkovski	K-523/14	Vrasje	Dënim me burg
Jordan Velkovski	K-597/14	Vrasje	Dënim me burg
Jordan Velkovski	K-872/14	Vrasje	Dënim me burg
Nazif Ilijazi	K-656/14	Vrasje	Dënim me burg

Nga të dhënat që janë paraqitur në tabelën e sipërme, për vitin 2014, që u është shqiptuar dënim me burg.

Tabela numër 8.¹²¹

Gjyqtar	Numri i lëndës	Lloj i veprës penale	Vendim
Betim Jahja	K-185/15	Vrasje	Dënim me burg
Betim Jahja	K-712/15	Vrasje	Dënim me burg
Betim Jahja	K-791/15	Vrasje	Dënim me burg
Verka Kostobska	K-102/15	Vrasje	Dënim me burg
Verka Kostobska	K-597/15	Vrasje	Dënim me burg
Verka Kostobska	K-656/15	Vrasje	Dënim me burg
Verka Kostobska	K-713/15	Vrasje	Dënim me burg
Verka Kostobska	K-752/15	Vrasje	Dënim me burg
Verka Kostobska	K-767/15	Vrasje	Dënim me burg
Nazif Ilijazi	K-742/15	Vrasje	Dënim me burg
Nazif Ilijazi	K-762/15	Vrasje	Dënim me burg

Nga të dhënat që janë paraqitur në tabelën e sipërme, për vitin 2015, që u është shqiptuar dënim me burg.

¹²⁰ Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Tetovës.

¹²¹ Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Tetovës.

Tabela numër 9.¹²²

Gjyqtar	Numri i lëndës	Lloj i veprës penale	Vendim
Ajrulla	K-29/16	Vrasje	Dënim me burg
Betim Jahja	K-575/16	Vrasje	Dënim me burg
Jordan Velkovski	K-720/16	Vrasje	Dënim me burg
Sadulla Izairi	K-318/16	Vrasje	Dënim me burg
Sadulla Izairi	K-55/16	Vrasje	Dënim me burg

Nga të dhënat që janë paraqitur në tabelën e sipërme, për vitin 2016, që u është shqiptuar dënim me burg.

Tabela numër 10.¹²³

Gjyqtar	Numri i lëndës	Lloj i veprës penale	Vendim
Betim Jahja	K-335/17	Vrasje	Dënim me burg
Betim Jahja	K-457/17	Vrasje	Dënim me burg
Verka Kostobska	K-155/17	Vrasje	Dënim me burg
Verka Kostobska	K-198/17	Vrasje	Dënim me burg
Jordan Velkovski	K-206/17	Vrasje	Dënim me burg
Nazif Ilijazi	K-321/17	Vrasje	Dënim me burg
Sadulla Izairi	K-163/17	Vrasje	Dënim me burg

Nga të dhënat që janë paraqitur në tabelën e sipërme, për vitin 2017, që u është shqiptuar dënim me burg.

Tabela numër 11.¹²⁴

Gjyqtar	Numri i lëndës	Lloj i veprës penale	Vendim
Betim Jahja	K-288/18	Vrasje	Dënim me burg
Betim Jahja	K-488/18	Vrasje	Dënim me burg
Betim Jahja	K-80/18	Vrasje	Dënim me burg
Jordan Velkovski	K-489/18	Vrasje	Dënim me burg
Jordan Velkovski	K-561/18	Vrasje	Dënim me burg
Jordan Velkovski	K-600/18	Vrasje	Dënim me burg
Nazif Ilijazi	K-120/18	Vrasje	Dënim me burg

Nga të dhënat që janë paraqitur në tabelën e sipërme, për vitin 2018, që u është shqiptuar dënim me burg.

¹²² Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Tetovës.

¹²³ Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Tetovës.

¹²⁴ Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Tetovës.

Në emër të qytetarëve të RM-së

Gjykata Themelore në Tetovë si gjykatë penale e shakllës së I, në kshillë të përbërë nga gjykatësja D-r Verka Kostovska, si kryetare e trupit gjykues, gjykatësi Hasan Asani, si anëtar i trupit gjykues, gjykatësit porot Velko Bllazhevski, Sanije Gafuri dhe Gordana Nakovska, si dhe procesmbajtësi Dragica Nakovska, duke vendosur aktakuzën e Prokurorisë Themelore Publike në Tetovë Ko.nr.428/15 më datën 07.10.2015 me të cilin akuzohet R.J. nga fshati Reçica e Madhe dhe A.M. nga fshati Reçica e Madhe për veprën penale “VRASJE” në nenin 123 p.2 pika 3 me nenin 22 të Kodit Penal, pasi u mbajtë senaca kryesore, publike dhe seanca gojore nga dita 03.10.2016 në prani të prokurorit publik Bashkim Hiseni, advokati i palës së dëmtuar adv, Hesat Ismaili nga Tetova, i pandehuri R.J. dhe mbrojtësi i tij adv.Mirosllav Vujiq nga Shkupi, i pandehuri A.M. dhe mbrojtësi i tij adv.Divna Pavllovska avokate nga Tetova dhe e solli në ditën 07.10.2015 publikuar publikisht tjetër:

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

1. R.J. i lindur më 31.01.1985, nga Tetova por jeton në fshatin Reçica e madhe, është i martuar ka 2 fëmijë, ka punuar si roje sigurie, me të ardhura mujore nga 12.000 denarë, i arsimuar me një dilomë të shkollës së mesme, i padënuar, shqipëtar, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
2. A.M. i lindur më 02.05.1992, nga Tetova jeton në fshatin Reçica e madhe, i martuar, babai i një fëmije, ka punuar si roje sigurie, me rrogë 12.000 denarë, i arsimuar me arsimim fillor të mbaruar, i dënuar me K.nr.546/12 më 10.06.2013 për një krim n.235 p.3 me dënim me burgim 6 muaj me kusht prej 1 viti, se nuk do të kryejë vepër penale tjetër, shqipëtar, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Janë fajtor

Sepse:

Më 10.04.2015 në MB Bar-Kodi i vendosur në rrugën JNA në pronësi të A.S. dhe S.F, të dy të akuzuar për bashkëkryerës që e privuan me dashje nga jeta A.A. nga fshati Poroj në moshën rreth 22 vjet, dhe më pas qëllimisht rrezikuan jetën e të dëmtuarve P.TH. nga Tetova, XH.XH. nga fshati Bogovinë, S.S, V.M, B.R. dhe A.A. të gjithë nga Tetova, në mënyrë që ata kishin hyrë më parë në lokal dhe janë bindur që A.A ishte në të njejtën tavolin me personat A.K, K.R, T.SH dhe A.L, më pas, duke dalë nga lokali, i akuzuari A.M. me dorë e thirën A.A. të dalë jashta për të pasur keqkuptime në lidhje me një mosmarrëveshje të mëparshme midis të pandehurve dhe A.A. dhe mikut të tij A.K, dhe meqenëse A.A. nuk dilte jashtë lokalit, të pandehurit u kthyen përsëri për një kohë të shkurtër në lokal, iu afrua masës së A.A. tani të ndjerë dhe, me të pandehurin A.M. duke nxjerrë një markë armë zjarri NN dhe i pandehuri R.J. qëllloi me armë zjarri të markës Zastava M-88 kalibër 9 mm. me numër 80676 dhe u drejtuan kah A.A., ku i pandehuri R.J. gjuajti disa plumba në të, duke e goditur me 3 plumba, duke shkaktuar 3 plagë me armë zjarri në pjesën e sipërme të krahut të majtë, në anën e djathtë të barkut dhe pjesën e përparme të gjoksit, në formën e dëmtimit të kanalit në venën e zezë dhe venën e portalit duke shkaktuar gjakderdhje të gjerë në bark dhe në gjoks, pas së cilës A.A. u hakmor me një sulm me pistoletë të markës NN, duke gjuajtur me disa plumba të pandehurin, duke goditur të pandehurin A.J. në pjesën e kockave të krahut të majtë, duke shkaktuar lëndime trupore në pjesën e pasme dhe në shpatullën e majtë, me A.A. gjatë rrugës për në Spitalin Acibadem Sistina në Shkup duke iu ëndshtruar lëndimeve ndërsa i dëmtuari P.TH. ka pësuar një lëndim trupor të indit të butë të gjurit të majtë, si dhe të tjerët kan pasur lëndi trupore.

Me të cilën veprimet e të pandehurive kryen vepren penale “Vrasje” nga neni 123 p.2 pika 3 me nenin 22 të Kodit Penal.

DËNOHEN

I pandehuri R.J. u dënua me burg të gjatë deri 40-dyzetë vjet.

I pandehuri A.M. u dënua me burg të gjatë deri 40-dyzetë vjet.

Në zbatim të nenit 47 të Kodit Penal, dënimi me burgim duhet të llogaritet për kohën e kaluar në paraburgim të konsideruar nga i pandehuri R.J. prej 22.04.2015 dhe për të pandehurin A.M. prej 14.04.2015.

ARSYETIM

Me aktakuzën e Prokurorisë themelore publike të Tetovës, KO.nr.428/15 nga 07.10.2015, të pandehur janë R.J. dhe A.M. nga fshati Reçicë e Madhe, për vepër penale “Vrasje” nga neni 123 p.2, pika 3, lidhur me nenin 22 nga Kodi Penal.

Për këtë rast penal gjykata, mbajti seancë kryesore publike dhe gojore, në prani të prokurorit publik B.H. dhe avokatit N.I, të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre.

Në fjalimin hyrës përfaqësuei i prokurorisë deklaroi se gjatë senacës kryesore, me shkresat e paraqitura dhe dëshmit verbale, do të rrëfej për të dy palët, si bashkëkryerës më datën 10.04.2015, rreth orës 22:00 në Tetovë, në kafenenë Barkod, rruga JNA, si bashkëpuntorë me paramendim e kanë privuar nga jeta A.A. nga fshati Poroj, dhe me paramendim kanë rrezikuar jetën e personave të tjerë në mënyrë që është përshkruar në dispozitiv.

Të pandehurit në fjalim hyrës deklaruan se e kuptojnë aktakuzën, dhe e din se janë të pandehur, çfarë veprë iu ngarkohet dhe nuk deklarohen si fajtorë për veprën penale.

Në fjalimin hyrës, mbrojtësi i të pandehurit R.J. tha se gjatë shqyrtimit kryesor, do të vërtetojë se i ndjeri A.A. ka pasur armë dhe ai i pari ka filluar të gjuaj, gjithashtu i pandehuri A.M. ka lëndime në pjesën e pasme të trupit dhe sipas kësaj nuk ekzistojnë rrethana për të kulaifikuar neni 123 p.2 pikën 3 dhe nenin 22 nga Kodi Penal.

Të pandehurit R.J. dhe A.M. i mbështetën fjalët e avokatëve të tyre.

Në fazën dëshmuese, gjykata i paraqiti këto dëshmi: video KPP.nr.45/15 nga data 11.04.2015, procesverbalin për kryerje në vendngjarje, bastisje më datën 14.04.2015, deklaratë nga spitali i Tetovës nr.031035/2 më datën 22.04.2015, deklaratë nga dëshmitarët etj.

Në fund, gjykata mori parasysh fjalimin hyrës, përfundimtar, të gjitha provat dhe rrethanat nga neni 39 i Kodit Penal.

Si rrethana rënduese gjyqi ka pasur parasysh, numrin më të madh të të lënduarve, se vepra është kryer gjatë ëikendit, ku ka pasur shumë njerëz për arsye se ka patur mbrëmje, sharjet etj. Të gjitha këto janë marrë si rrethana rënduese.

Si rrethanë lehtësuese është marrë parasysh mosha, dhe statusi ekonomik familjar.

Gjyqi i detyroi të pandehurit të paguajnë një shumë prej 6000 denarë dhe në pajtim me nenin 100 nga Kodi Penal u merrë armët modeli Zastava M-88, kalibër 9 mm me numër 80676, si material me të cilat është kryer vepra penale.

Gjykuar në Gjykatën Themelore të Tetovës, më datën 07.102016, lënda K.nr.752/15.

Këshilli juridik: Kundër këtij vendimi lejohet ankesë në afat prej 1 ditëve, përmes Gjykatës të Apelit në Gostivar.

Në fund është dërguar ankesë deri te Gjykata e Apelit në Gostivar, ndërkaq ankesat janë vlerësuar si të pavlefshme.

Sipas mendimit tim, shqiptimi i dënimit besoj se është i drejtë, për faktin se “Vrasja” ka qenë e rënd ku është privuar jeta e personit, pastaj ka rrethana rënduese si mosha e viktimës që ka qenë relativisht e re, vrasja është kryer me paramendim, me qëllim dhe ka qenë në publik. Andaj mendoj se gjykata ka dhënë vendim korrekt.

3. POLITIKA KRIMINALE

3.1 Politika kriminale dhe lidhjet e saj me shkencat e tjera

Politika kriminale është ngushtësisht e ndërlidhur me shumë disiplina të tjera shkencore, të cilat i ofrojnë ndihmë gjatë procesit të formimit të sistemit të saj dhe gjatë arritjes më të madhe të aplikueshmërisë së saj. Kjo ndërlidhje e politikës kriminale me disiplina të caktuara është shumë e fortë, kurse me disa të tjera është e zhvilluar më pak. Ajo me disa shkenca është e lidhur aq shumë sa kurrsesi nuk do të mund të zhvillohej sistemi aplikativ teorik, që do të kishte aftësi të merrej me sjellje të rrezikshme shoqërore. Në rradhë të parë, këtu hyn shkenca juridiko-penale, pa të cilën ajo as që mund të mendohet, pastaj kriminologjia, kriminalistika, penologjia dhe politika sociale, të cilat po ashtu hyjnë në rrethin e ngushtë shkencor, me të cilat politika kriminale është ngushtësisht e lidhur. Në rendin e dytë bëjnë pjesë shkencat që janë shumë të rëndësishme, por, megjithatë, nuk janë aq të nevojshme sikurse shkencat e rendit të parë. Këtu bëjnë pjesë sociologjia, psikologjia, psikologjia sociale, pedagogjia dhe disiplinat e tjera, të cilat me njohuritë dhe përvojat e veta mund të ndihmojnë shumë për koncipimin e suksesshëm të funksionimit të politikës kriminale në luftimin e kriminalitetit¹²⁵.

3.1.1 Politika kriminale dhe drejta penale

E drejta penale studion edhe interpreton në mënyrë kritike të drejtën penale pozitive të një shteti. Ajo i definon sjelljet e ndryshme në shoqëri, si sjellje të rrezikshme dhe të dëmshme si veprime të inkriminuara në ligje pozitive penale. E drejta penale merret me analizën dhe përkufizimin e veprave penale dhe sanksioneve penale të parapara në ligje pozitive penale¹²⁶.

Politika kriminale dhe drejta penale janë disiplina shumë të ndërlidhura. Politika kriminale është pasuruar gjatë historisë vetëm me birmet e së drejtës penale dhe të bazës së saj normative në legjislacionin penal. E drejta penale dhe legjislacioni penal i kanë qëllimet dhe metodat që janë aplikuar në praktikën plotike kriminale. E drejta penale me legjislacionet e veta penale, në kushtet e sotme ka rëndësi shumë të madhe politike. Në të drejtën penale dhe në legjislacionin penal është e theksuar forma juridike e politikës kriminale e çdo vendi i tërë sistemi juridiko-penal, duke filluar prej përcaktimit të qëllimeve dhe prej inkriminimit të disa veprimeve, është i orientuar në këtë drejtim. E drejta penale shërben si disiplinë e domosdoshme për luftimin e kriminalitetit, si qëllim themelor i politikës kriminale, që ndërtohet sipas bazave të saj, është emëruar si formë e luftës

¹²⁵ Latifi.Veseli,Politika Kriminale,Prishtinë,2011,faqe 18-19.

¹²⁶ Po aty,faqe 19.

juridiko-penale kundër kriminalitetit. E drejta penale është një shkencë teoriko-praktike e cila studion veprimet dhe mosveprimet e konsideruara nga shoqëria si të kundërligjshme dhe të rrezikshme. Qëllimi i saj është përcaktuar që në nenin 1 të Kodit Penal ku thuhet se: “Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre”. Në paragrafin e dytë të nenti 2 të Kodit Penal thuhet, gjithashtu, se: “Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe mas dënimi të parashikuar në ligj” (Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1995). Ky kod përcakton sanksionet penale që mund të zbatohen ndaj një personi që ka kryer një vepër penale, përcakton rrethanat lehtësuese dhe rënduese që duhet të merren parasysh gjatë caktimit të llojit dhe masës së dënimit¹²⁷.

Parimi i ligjshmërisë, (nullum crime sine lege dhe nullum poena sine lege - s’ka krim pa ligj, s’ka dënim pa ligj) shkolla klasike juridike-penale, e themeluar nga Cesar Bekaria, shpalli parimin e njohur të ligjshmërisë: “Nullum crimen, nulla pena sine lege”, si bazë juridike për marrjen e personit në përgjithësi penale dhe dënimin e tij. Pa u parashikuar në ligj, nuk mund të jepej dënim, ndryshe nuk mund të quhej i drejtë është *conditio sine qua non* (kusht pa të cilin nuk mundet) që e drejta penale me dispozitat e veta dhe aplikimin e tyre të sigurojë të gjithë qytetarëve siguri juridike dhe të vendos raporte të drejta midis parimit të shtetit juridik dhe kërkesës së shtetit social, dhe të ketë efekte frikësuese meqë çdo njeri e dinë çka e pret nëse kryen vepër penale¹²⁸.

Politika kriminale si disiplinë e pavarur juridiko-penale e ushtron ndikimin e vet në shkencën juridiko-penale, në zhvillimin e saj, në kultivimin dhe në përsosjen e saj teorike. Politika kriminale formohet edhe zhvillohet në bazë të qëndrimeve të së drejtës penale, në mënyrë që ta hapë rrugën e hulumtimeve shkencore dhe të ndihmojë orientimin e së drejtës penale për zgjidhje më efikase nga aspekti politik-kriminal për afrimin e saj të pandërprerë me jetën praktike. Detyra kryesore e shkencës së të drejtës penale është studimi dhe avancimi i së drejtës penale apo legjislationit penal që gjendet në fuqi në vendin e caktuar. Kjo shkencë merret me studimin e kuptimit juridik të veprës penale, të llojeve dhe formave të veprave penale, e studion kryerësin dhe përgjegjësinë penale të tij, si dhe sanksionet penale. Lufta kundër kriminalitetit doemos duhet të zbatohet para së gjithash me aplikimin me një sistem të ndryshëm, përmbytësor dhe të sinkrotizuar të masave preventive, me koordinimin e plotë të organeve që i aplikojnë. Koordinimi i tillë i masave të politikës kriminale dhe lidhshmëria e tyre e domosdoshme janë parakusht i nevojshëm për çdo politikë shoqërore, racionale dhe efektive të luftimit të kriminalitetit¹²⁹.

¹²⁷ Latifi.Veseli,Politika Kriminale,Prishtinë,2011,faqe 19-20.

¹²⁸ Po aty,faqe 20.

¹²⁹ Po aty,faqe 20-21.

PËRFUNDIMI

Përmes këtij punimi jepet një pasqyrë e saktë duke u mbështetur në të dhënat statistikore të gjykatës themelore në Tetovë lidhur me numrin e dënimeve të cilat i shqipton kjo gjykatë në raport vjetor, qëllimin e dënimeve karakteristikat e kryerësit (mosha, gjinia, përkatesia etnike fetare etj) si dhe efektin e dënimit. Vepër penale paraqitet vetëm ajo sjellje që është e parashikuar me ligj si vepër penale (tipiciteti)! Kuptimi i parimit të ligjshmërisë si parim themelor i së drejtës penale bashkëkohore përbëhet mu nga kërkesa që ligjit në mënyrë precize t'i caktojë kufijët në mes sjelljeve ndëshkuese dhe jondëshkuese, duke e garantuar lirinë e individit nga njëra anë, dhe duke i sjell nën grushtin e dënimit sjelljet që paraqesin shkelje të të mirave individuale dhe shoqërore! Viktima e veprës penale është personi fizik apo juridik që e godet pasojën e përfshirë në figurën ligjore të veprës (vdekje në vrasje, lëndim trupor etj.) Statusi i të dëmtuarit ka jo vetëm viktimën e drejtpërdrejtë, por edhe viktimën sekondare që aktivohet në rast kur viktima primare nuk ekziston apo është në moshë apo në gjendje momentale që i mundëson t'i realizojë të drejtat e veta. Ashtu, në veprën vrasje, të dëmtuar janë të afërmit e vrasësit! Sistemi i elementeve të nocionit të veprës penale nuk guxon të inklinoj nga koncepti kryesor i funksionit dhe parimeve të së drejtës penale! Sistemi domethënë paranim të ligjeve të caktuara logjike për raportet e brendshme në mes pjesëve përbërëse të tij, që ka të bëjë me ligjdhënësin i cili nuk mund të improvizojë me të gjithë nocionet e përmendura, duke vënë ato në një rregullim kaotik, por po ashtu ndaj gjykatës që nis nga sistemi ashtu i vënë gjatë interpretimit teleologjik të ligjit dhe zhvillimit të “teknologjisë” së vendosjes gjyqësore: gjykata vërteton ekzistimin e veprimit, e më pas përcaktueshmërinë në ligj etj.

Elementi i fundit është dënimi i veprës! Vepra penale është sjellje për të cilën është paraparë dënim që i shqiptohet kryerësit të fajshëm. Nuk ka vepër penale nëse si pasojë e saj juridike nuk është paraparë dënim (*Nullum crime sine poena!*). Parashikimi i dënimit është kriter më i sigurt pas të cilit vepra penale dallohet nga sjelljet tjera kundërligjore (*deliktet civile*). Pra, dënimi është sanksioni kryesor.

Prandaj, unë personalisht kam vendosur ta trajtoj këtë temë për faktin se vrasjet e rënda, kohëve të fundit janë duke u zgjeruar në mënyrë rapide, dhe qytetarët ndjehen disi të friksuar dhe të pasigurt nga organet e drejtësisë për shkak të numrit të errët të këtyre rasteve dhe se dënimi që u shqiptohet këtyre kryerëseve nuk është adekuat. Shpresoj që ky punim të shërbej si ekzemplar për të gjithë qytetarët për të mbushur akoma më shumë diapazonin e diturisë juridike, dhe për personat me profil juridik që t'ju shërbej si udhërrëfyes në jetën e tyre profesionale.

REKOMANDIMET

Punimi shkencor me titull: *“Vepra penale e vrasjeve të rënda në rrethin e Gjykatës Themelore në Tetovë për periudhën 2012 deri 2018”*, është i një rëndësie të veçantë për faktin se bëhet fjalë për një materie shumë të rëndësishme me impakt të jashtëzakonshëm në jetën shoqërore. Rëndësia e këtij punimi vjen në shprehje përveç tjerave edhe për faktin se trajton një ndër aspektet kyçe të të drejtës penale, që është-risocializimi dhe sfidat me të cilat përballlet institucioni që është objekt i këtij hulumtimi në arritjen e këtij synimi aq shumë të dëshiruar. Bëhet fjalë për një studim autentik, për të cilin ka nevojë literatura juridike dhe që do të shërbejë për tua hapur rrugën studiuesve të rinj të cilët janë të interesuar të hulumtojnë tema të ngjashme. Duke u mbështetur në këto arsye kam vendosur të shkruaj temën e lartëpërmendur me shpresën se përmes saj do të trasoj një rrugë të re drejt studimit të aspekteve të përmendura më lartë që janë të rëndësisë së veçantë në lëmin e së drejtës penale në përgjithësi dhe në lëmin e penologjisë si degë e të drejtës penale në veçanti.

LITERATURA

-I- Libra, monografi dhe punime kërkimore shkencore.

1. Halili, Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2011.
2. Halili, Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2000.
3. Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2016.
4. Osmani, Afrim, Komentari i ligjit për egzekutimin e sanksioneve, Shkup, 2013.
5. Zejneli, Ismail, E drejta Penale Pjesa e Posaçme, Tetovë, 2007.
6. Zejneli, Ismail, Delikuenca e të miturve në RM, Tetovë, 2016.
7. Kambovski, Vllado, E drejta Penale Pjesa e Përgjithshme, Shkup, 2010.
8. Kambovski, Vllado & Zejneli, Ismail, E drejta Penale Pjesa e Përgjithshme, Tetovë, 2018.
9. Kombovski, Vllado, Kazeno pravo-poseban del, Skopje, 2003.
10. Sahiti, Ejup & Zejneli, Ismail, E drejta e Procedurës Penale e RM-së, Shkup, 2017.
11. Latifi, Vesel, Politika kriminale, Prishtinë, 2011.
12. Latifi, Vesel, Politika e parandalimit të krimit, Prishtinë, 2013.
13. Gruda, Zejnullah, Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, Shkup, 2007.
14. Hysa, Vasilika 'Kriminologjia' Tiranë, 2005.
15. Salihu, Ismeti, E drejta Penale Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë, 2012.

-II- Kushtetuta, kode, ligje, akte ndërkombëtare dhe akte tjera.

1. Osmani, Afrim, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2010.
2. Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale të R.M- së, Shkup, 2006 (Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë, Nr.2/06).
3. Ligji mbi procedurën penale të R.M- së, Shkup, 1996,2005 (Gazeta zyrtare e R.Mqedonisë, Nr.15/05).
4. Ligji për kundërvajtje i R.Maqedonisë, Shkup, 2006 (Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë, Nr.62/06).
5. Ligji për gjykata i R.Maqedonisë, Shkup,2006 (Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë,Nr.58/06).

-III- Praktika gjyqësore

1. Vendime të plotëfuqishme të Gjykatës Themelore të Tetovës për vitet 2012-2018.
2. Statistika dhe evidenca për rastet e dënuara me burgim nga arkiva e gjykatës themelore të Tetovës për vitet 2012-2018.
3. Statistika dhe evidenca nga Enti shtetëror për statistik i Republikës së Maqedonisë.

-IV- Interneti

1. www.stat.gov.mk
2. www.pravda.gov.mk.
3. www.pravo.org.
4. www.library.seeu.edu.mk

Falenderimet i takojnë Allahut (xh.sh.)!

Këtë mund ua kushtoj gjyshërve të mi dhe prindërve të mi, dhe me këtë dua t'i nderoj për dashurinë dhe përkrahjen e vazhdueshme dhe të parezervë që më ndihmuan në arritjen e suksesit tim.

Ju faleminderit.